



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 26 regjistër (JR)  
Datë 01.07.2020

Nr. 08 i vendimit  
Datë 07.04.2022

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Relator</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 07.04.2022, ora 15:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Steven Kessler, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 26/2020 (JR), datë 01.07.2020, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Edmond Hyka, me detyrë prokuror në Prokurorinë e Apelit Tiranë.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 223, datë 20.12.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Edmond Hyka.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 3, 4, 5, 7, 15, 17, 18, 28, 30, 31, 33, 42, 43, 116, 122 të Kushtetutës; nenet A, B, C, Ç, D, Dh, E dhe F të Aneksit të Kushtetutës; nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; nenet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 10, 12, 13, 14, 17, 30 dhe 41 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; nenet 1, 4, 7, 10, 11, 13, 14, 16, 18, 19, 20 e në vijim të Kodit të Procedurës Civile; nenet 1, 6, 7, 13, 14, 17 dhe 18 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe Protokollin nr. 12 i kësaj konvente.

## Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike në prani të subjektit të rivlerësimit Edmond Hyka, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e tij të paraqitura në ankim, si dhe pasi dëgjoi në seancë gjyqësore subjektin e rivlerësimit dhe avokatin e tij, z. J. D., të cilët kërkuan përfundimisht ndryshimin e vendimit nr. 223, datë 20.12.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin e subjektit të rivlerësimit në detyrë, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

### VËREN:

#### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Edmond Hyka, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, ai iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor<sup>1</sup>, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë<sup>2</sup>, deklaratën për kontrollin e figurës<sup>3</sup> dhe formularin e vetëvlerësimit profesional<sup>4</sup>.
3. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
  - (i) *Deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin, ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me deklaratimet e tij.*
  - (ii) *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.*
  - (iii) *Ka mosdeklarime të pasurisë.*
  - (iv) *Ka kryer deklaram të rremë.*
  - (v) *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

---

<sup>1</sup> Afati ligjor prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë, kontrollit të figurës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, ka përfunduar më datë 31.01.2017.

<sup>2</sup> Dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 27.01.2017, sipas vërtetimit të ILDKPKI-së me nr. {\*\*\*} prot., datë 27.01.2017. Të njëjtën datë mban edhe deklaratat e pasurisë në rubrikën përkatëse.

<sup>3</sup> Referuar raportit mbi kontrollin e figurës të përgatitur nga Grupi i Punës pranë DSIK-së.

<sup>4</sup> Referuar “Formularit të vetëvlerësimit profesional” dhe raportit nr. {\*\*\*} prot., datë 05.07.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për “Analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Edmond Hyka për periudhën 08.10.2013 deri më 08.10.2016”, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar pranë Prokurorisë së Përgjithshme formularin e vetëdeklarimit më datë 24.01.2017.

4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. DSIK-ja dërgoi një raport të arsyetuar pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.
5. Këshilli i Prokurorisë së Përgjithshme, nëpërmjet Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale<sup>5</sup>, ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar pranë Komisionit një raport të hollësishëm<sup>6</sup> dhe të arsyetuar mbi subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.
6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Edmond Hyka, bazuar në tri kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale), duke marrë vendimin nr. 223, datë 20.12.2019.

## **II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

7. Komisioni, me vendimin nr. 223, datë 20.12.2019, vendosi: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Edmond Hyka, me detyrë prokuror në Prokurorinë e Apelit Tiranë [...]”.
8. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme.

**8.1.** *Në lidhje me kontrollin e pasurisë, nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera prej tij dhe personat e lidhur, ndër vite. Subjekti ka pasaktësi dhe mospërrputhje në deklarime, si dhe deklarim të pamjaftueshëm të pasurisë, ndër vite.*

**8.2.** *Në lidhje me kontrollin e figurës, Komisioni, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar prej subjektit të rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e DSIK-së, informacionet nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit të ketë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo që të jetë i përfshirë, apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë, e gjen atë të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.*

<sup>5</sup> Referuar ligjit nr. 84/2016 dhe ligjit nr. 96/2016.

<sup>6</sup> Dërguar me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 31.07.2018.

**8.3.** Në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale, nga vlerësimi tërësor i kriterit profesional, janë konstatuar mangësi dhe problematika në aspektin procedural nga subjekti i rivlerësimit në nivel minimal, si dhe një situatë konflikti interesi, por trupi gjykues vlerëson se nuk janë deri në atë masë që të plotësojnë qëllimin e nenit E të Aneksit të Kushtetutës apo pikës 4 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe, për rrjedhojë, Komisioni, duke marrë në konsideratë edhe parimin e proporcionalitetit, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, sipas parashikimit të germës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, arrin një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **III. Shkaqet e ankimit**

9. Subjekti i rivlerësimit iu drejtua Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim referuar “Kolegji”) me ankim kundër vendimit të Komisionit nr. 223, datë 20.12.2019, me pretendimin se vendimi ishte i padrejtë dhe i pambështetur në prova, fakte dhe ligj, në Kushtetutën e Shqipërisë, si dhe në aktet ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë. Sipas subjektit të rivlerësimit, vendimi objekt ankimi ishte i paracaktuar dhe rezultat i cenimit të normave ligjore procedurale për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, por gjithashtu edhe rezultat i vlerësimit të gabuar të rrethanave faktike të provuara gjatë procesit administrativ për vlerësimin e kriterit të pasurisë. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se konkluzionet e arritura nga Komisioni lidhur me kriterin e pasurisë, nuk janë rrjedhojë e vlerësimit të drejtë dhe të paanshëm të provave të administruara dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, dhe as në përputhje me praktikën gjyqësore.
10. Subjekti i rivlerësimit ankimin e tij e shoqëroi me disa akte shkresore, për të cilat kërkoi marrjen në cilësinë e provave të reja. Bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, subjekti i rivlerësimit Edmond Hyka kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe të vendosë:
  - *Gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike.*
  - *Konstatimin e shkeljeve të të drejtave kushtetuese dhe atyre të parashikuara nga KEDNj-ja, ndaj subjektit të rivlerësimit Edmond Hyka, prokuror në Prokurorinë e Apelit Tiranë.*
  - *Çeljen e shqyrtimit gjyqësor dhe administrimin e provave të reja.*
  - *Ndryshimin e vendimit nr. 223, datë 20.12.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Edmond Hyka, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.*
11. Shkaqet e ankimit lidhur me aspektet procedurale, si dhe ato të zbatimit të ligjit material, parashtrihen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.
  - 11.1.** *Komisioni ka kryer shkelje të rënda procedurale: (i) ka filluar seancën dëgjimore pa kryer më parë legjitimimin e palëve; (ii) trupi gjykues (kryesuesi) nuk ka bërë prezantimin e anëtarëve të tij, nuk ka pyetur përfaqësuesin e subjektit nëse ishte dakord me përbërjen e trupit gjykues dhe*

*as nuk i ka bërë të ditur atij të drejtën për të bërë kërkesa paraprake apo ta pyeste nëse kishte ndonjë të tillë.*

**11.2.** *Komisioni ka shkelur nenin 7 të KEDNj-së për shkak se është cenuar parimi i sigurisë juridike dhe e drejta e mbrojtjes nëpërmjet heshtjes.*

**11.3.** *Komisioni, me dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, ka cenuar nenin 8 të KEDNj-së për shkak se nuk është zbatuar parimi i proporcionalitetit në dhënien e masës disiplinore.*

**11.4.** *I gjithë procesi i rivlerësimit është i parregullt dhe në kundërshtim të hapur me Kushtetutën, KEDNj-në dhe normat e tjera të së Drejtës Ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë.*

**11.5.** *Komisioni ka cenuar parimin e barazisë së subjekteve para ligjit pasi, në raste të ndryshme rivlerësimi, ka mbajtur standarde të ndryshme kuptimi dhe zbatimi të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.*

**11.6.** *Komisioni ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit në kundërshtim me parashikimet e nenit 61, pika 1, duke qenë se subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në kushtet e dyfishit të pasurisë së ligjshme. Komisioni ka vendosur në kundërshtim edhe me parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në kushtet kur kjo dispozitë ligjore kërkon plotësimin në mënyrë kumulative dhe jo alternative të dy kriterëve: pamjaftueshmërisë në kontrollin e figurës dhe pamjaftueshmërisë në vlerësimin e pasurisë.*

**11.7.** *Komisioni ka interpretuar në mënyrë të gabuar nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 në drejtim të kuptimit të konceptit të deklarimit të pamjaftueshëm.*

**11.8.** *Komisioni ka cenuar të drejtën e subjektit të rivlerësimit për proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNj”), si pasojë e faktit se (i) subjekti nuk është gjykuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e krijuar me ligj; (ii) nuk është respektuar parimi i kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve; si dhe (iii) nuk është garantuar gjykimi i çështjes brenda një afati të arsyeshëm.*

**12.** *Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.*

**12.1.** *Komisioni ka arritur në konkluzion të gabuar në vlerësimin e kriterit të pasurisë si pasojë e mosmarrjes në konsideratë të pasurisë së fituar nga subjekti i rivlerësimit nga trashëgimia ligjore, pas largimit nga jeta të trashëgimlënësit, babait të tij, në vitin 2009.*

**12.2.** *Lidhur me pasurinë e paluajtshme “apartament banimi” me sipërfaqe 121 m<sup>2</sup> dhe “dyqan” me sipërfaqe 52,5 m<sup>2</sup>, në Durrës:*

**12.2.1.** *Subjekti kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit për deklarim të pasaktë të këtyre pasurive sa i takon vitit të përfitimit të tyre dhe shpjegoi se këto pasuri janë poseduar de-*

*facto më parë se të realizohej kontrata e shitblerjes dhe, për këtë arsye, në deklaratimet e tij si vit i krijimit të këtyre pasurive është deklaruar “viti real i përfitimit të tyre”.*

**12.2.2.** *Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të padrejtë vlerësimin e Komisionit lidhur me të ardhurat e realizuara prej tij si pasojë e ushtrimit të aktivitetit të avokatisë në periudhën 2000-2005 dhe të gabuar mënyrën e përlogaritjes së këtyre të ardhurave.*

**12.2.3.** *Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi konkluzionin e Komisionit në drejtim të vlerës së deklaruar të pasurive, me pretendimin se vlera e këtyre pasurive është përcaktuar me vullnet të lirë të palëve dhe është pasqyruar saktësisht dhe rregullisht në kontratë.*

**12.3.** *Subjekti kundërshtoi si të pambështetur në ligj konkluzionin e Komisionit për moskonsiderimin si të ligjshme të të ardhurave të përfituara nga marrëdhënia e qirasë së dyqanit me sip. 52,5 m<sup>2</sup> në periudhën 29.03.2007 - 28.03.2013 - 02.01.2016, me pretendimin se detyrimin ligjor për pagimin e tatimit mbi këto të ardhura, në kuadër të parashikimeve të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, e ka pasur pala qiramarrëse në cilësinë e subjektit tatimpagues.*

**12.4.** *Konkluzioni i Komisionit për mungesën e burimeve të ligjshme për blerjen e pasurisë së paluajtshme “apartament” me sip. 65 m<sup>2</sup> nga djali i subjektit të rivlerësimit, G. H., është i pambështetur në fakte, pasi mbështetet në trajtimin e gabuar që u ka bërë Komisioni të ardhurave të prindërve të subjektit të rivlerësimit.*

**12.5.** *Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar në fakte dhe në ligj konkluzionin e arritur nga ana e Komisionit për pasaktësi në deklaratim, si pasojë e mosdeklarimit në DIPPV-në e vitit 2011 të trajtimit preferencial që ka të bëjë me shitblerjen e një automjeti tip “Benz”, blerë sipas kontratës nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 21.11.2011, para noterës M. Ç., në vlerën e 10.200 eurove.*

**12.6.** *Sa i takon likuiditetin në gjendje cash jashtë sistemit bankar, në vlerën e 10.000 eurove dhe 100.000 lekëve, subjekti i rivlerësimit pretendoi se konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e burimit të krijimit të këtij kursimi (trashëgimia ligjore), si të krijuar me burime jo të ligjshme financiare, është konkluzion i gabuar.*

**12.7.** *Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar në fakte edhe konkluzionet mbi analizën financiare të Komisionit lidhur me krijimin e pasurive të mëposhtme, me të njëjtin pretendim për vlerësim të gabuar të të ardhurave të krijuara nga prindërit e subjektit të rivlerësimit, të cilat janë përfituar në vitin 2009 nga subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet trashëgimisë ligjore:*

**12.7.1.** *Depozitë në BKT, dega Durrës, në obligacione me afat 2-vjecar, e hapur në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. E. H., në shumën e 4.500.000 lekë.*

**12.7.2.** *Të ardhura të përfituara nga subjekti i rivlerësimit nga depozita në bono thesari, në shumën 1.200.236 lekë dhe nga depozita në obligacione, në shumën 1.007.187 lekë.*

12.7.3. Depozitë në BKT, dega Durrës, në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. E. H., në shumën 20.000 euro.

12.7.4. Të ardhura të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. E. H., të përfituara nga depozitat në bono thesari, në obligacione dhe depozita bankare në shumën 1.635.639 lekë.

12.7.5. Depozitë në “Fibank”, në emër të vajzës së subjektit, I. H., në shumën 17.000 euro.

12.8. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si pa efekt në kuadër të kontrollit të pasurisë së tij dhe rezultateve të kriterit të pasurisë, konkluzionin e Komisionit se ai “nuk ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me mosdeklarimin e shitjes dhe blerjes së automjeteve në vitin 2009, si dhe mosdeklarimin e shitjes dhe blerjes së automjeteve në deklaratën e vitit 2011”.

13. Shkak i ankimit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.

13.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar konkluzionin e Komisionit lidhur me mosdeklarimin e heqjes dorë në çështjen penale me palë shtetasin I. Ç. Subjekti i rivlerësimit u shpreh në ankim se, pavarësisht se ky konkluzion nuk kishte shërbyer si shkak shkarkimi nga ana e Komisionit, ai kundërshtojë prej tij si i pabazuar në ligj, pasi subjekti pretendoi të mos jetë ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit, referuar parashikimeve të nenit 26, vlerësuar në raport me nenet 15, 16 dhe 17 të Kodit të Procedurës Penale, për t'i lindur detyrimi për heqjen dorë nga ushtrimi i funksionit të prokurorit.

#### IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

14. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit Edmond Hyka, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

15. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë

Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh<sup>7</sup> nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

16. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012, i ndryshuar”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhej me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 223, datë 20.12.2019, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.
17. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike me praninë e subjektit të rivlerësimit, si dhe kërkimin e tij për konstatimin e shkeljeve të të drejtave kushtetuese dhe atyre të parashikuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNj”), kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, si dhe vlerësoi dokumentacionin e fashikullit të administruar gjatë hetimit në Komision, bazuar edhe në jurisprudencën<sup>8</sup> e deritanishme të Kolegjit, konstatoi se gjatë procesit të rivlerësimit, është cenuar e drejta e subjektit të rivlerësimit për proces të rregullt ligjor në drejtim të mosgarantimit të së drejtës për mbrojtje efektive, si pasojë e caktimit nga Komisioni të afateve kohore të paarsyeshme, brenda të cilave subjekti i rivlerësimit duhej të përgatiste mbrojtjen e interesave të tij të ligjshëm, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të tij. Për rrjedhojë, trupi gjykues, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, në nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenin 51, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, vendosi shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, duke i garantuar subjektit të rivlerësimit të drejtën për t’u dëgjuar dhe mbrojtur para trupit gjykues të Kolegjit, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim.
18. Sa u takon akteve shkresore që subjekti i kishte bashkëlidhur ankimit, akteve të përcjella bashkëlidhur parashitësive të tij, si atyre të depozituara gjatë seancës gjyqësore para Kolegjit, analiza për pranueshmërinë e tyre u krye në kuadër të parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, vlerësuar në harmoni me nenin 51, pika 1, shkronja “a” e të njëjtit ligj, sipas të cilave subjekti i rivlerësimit nuk mund të paraqesë në ankim fakte të reja apo të kërkojë prova të reja,

---

<sup>7</sup> Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 223, datë 20.12.2019, për rivlerësimin e subjektit Edmond Hyka, i është njoftuar këtij të fundit me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 09.06.2020, konfirmuar marrja dijeni nga subjekti i rivlerësimit më datë 11.06.2020, sipas lajmërimarrjes së shërbimit postar. Kurse ankimi i subjektit rezultoi të jetë depozituar në Komision në datën 24.06.2020, konfirmuar sipas të dhënave të vulës së protokollit të Komisionit, nr. {\*\*\*}, datë 24.06.2020, që rezultoi të jetë dita e 13-të nga data e marrjes dijeni për vendimin e Komisionit, sipas njoftimit të këtij të fundit.

<sup>8</sup> Shih vendimet e Kolegjit nr. 12/2018 (JR), nr. 1/2019 (JR), nr. 7/2019 (JR), nr. 8/2019 (JR), nr. 15/2019 (JR), nr. 28/2019 (JR).



përveçse kur provon se pa fajin e tij, nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose të kërkojë marrjen e këtyre provave gjatë shqyrtimit në Komision. Gjithashtu, në vendimmarrjen e trupit gjykues mbi kërkesat e subjektit të rivlerësimit për marrjen e provave të reja, u mbajtën në konsideratë edhe parashikimet e nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të kësaj analize, trupi gjykues vendosi të pranojë në cilësinë e provave të reja aktet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, përveç disa komunikimeve elektronike me Komisionin, të cilat ishin pjesë e fashikullit të çështjes, si dhe një akti nënligjor me anë të të cilit ishte vendosur gjendja e fatkeqësisë natyrore në qarqet Tiranë dhe Durrës, akt i cili ishte i aksesueshëm për trupin gjykues nga Fletorja Zyrtare.

*B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit dhe çështje të zbatimit të legjislacionit*

19. Subjekti pretendoi në ankimin e tij se Komisioni ka kryer shkelje të rënda procedurale, si: (i) ka filluar seancën dëgjimore pa kryer më parë legjitimimin e palëve; (ii) trupi gjykues (kryesuesi) nuk ka bërë prezantimin e anëtarëve të tij, nuk ka pyetur përfaqësuesin e subjektit nëse ishte dakord me përbërjen e trupit gjykues dhe as nuk i ka bërë të ditur atij të drejtën për të bërë kërkesa paraprake apo ta pyeste nëse kishte ndonjë të tillë.

**19.1.** Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të Komisionit, konstatoi se në procesverbalin e seancës dëgjimore të zhvilluar në Komision më datë 19.12.2019, në momentin e çeljes së seancës dëgjimore është prezantuar përbërja e trupit gjykues, si dhe është kryer verifikimi i prezencës së subjektit të rivlerësimit, i cili rezultoi të ketë qenë në mungesë, por i përfaqësuar me avokat, prokura e të cilit ishte verifikuar nga ana e trupit gjykues. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit të rivlerësimit për shkelje procedurale të trupit gjykues në drejtim të sa më sipër, çmohen të pabazuara në fakte. Sa i takon pretendimit lidhur me kërkesat paraprake, nga kontrolli i kryer rezultoi se me të drejtë subjekti pretendoi se trupi gjykues nuk e ka pyetur përfaqësuesin e tij në fillim të seancës dëgjimore, nëse kishte kërkesa paraprake të natyrës procedurale, por pavarësisht kësaj, kërkesat rezultojnë të jenë parashtruar me iniciativë të përfaqësuesit me prokurë të subjektit të rivlerësimit dhe ato rezultuan të jenë marrë në shqyrtim nga ana e trupit gjykues. Për rrjedhojë, referuar përmbajtjes së transkriptit të procesverbalit audio të seancës dëgjimore, shkak i ngritur në ankim nga ana e subjektit të rivlerësimit, për shkelje të rënda procedurale të trupit gjykues gjatë seancës dëgjimore në Komision, nuk gjendet i drejtë dhe i mbështetur në fakte. Parregullsia e konstatuar në lidhje me momentin e bërjes së kërkesave paraprake, nuk vlerësohet se përbën shkak thelbësor për cenimin e procedurës së ndjekur nga Komisioni dhe, rrjedhimisht, cenimin e vlefshmërisë së vendimmarrjes së arritur prej tij.

**19.2.** Subjekti ka ngritur si shkak në ankimin e tij cenimin nga Komisioni të nenit 7 të KEDNj-së, me pretendimin se është shkelur parimi i sigurisë juridike dhe e drejta e mbrojtjes nëpërmjet heshtjes. Në mbështetje të këtij shkak ankimi, subjekti pretendoi se rregullat e përcaktuara për procesin e rivlerësimit dhe sidomos zbatimi i tyre në procesin e zhvilluar ndaj tij, janë të padrejta dhe në shkelje të parimit të sigurisë juridike. Gjithashtu ai pretendoi: “Subjekti i rivlerësimit nuk mund të shkarkohet nga detyra, si masë disiplinore e marrë nga një këshill disiplinor, për

pasaktësitë apo problemet që mund të konstatohen në DPV-të vjetore, për më tepër dekada më parë. [...] Nëse në procesin e rivlerësimit, subjekteve të rivlerësimit u jepet masa disiplinore e “shkarkimit nga detyra” për pasaktësitë apo shkeljet administrative që mund të kenë kryer në DPV-të vjetore, atëherë në këtë rast, do të cenoheshin parimet e njohura të procesit të rregullt ligjor *nullum crimen, nulla poena sine lege* dhe *mens rea*”. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni, me kërkesën drejtuar subjekteve për të justifikuar prejardhjen e ligjshme të pasurive nëpërmjet kalimit të barrës së provës, ka dhunuar parimin e prezumimit të pafajësisë dhe të drejtën e këtyre personave për t’u mbrojtur nëpërmjet përdorimit të së drejtës për të heshtur. Sipas subjektit të rivlerësimit, kjo ka sjellë edhe cenimin e parimit të barazisë mes personave të hetuar, objekt i ndëshkimit të këtij ligji<sup>9</sup>, dhe personave që u nënshtrohen hetimeve për vepra të tjera penale. Sipas subjektit të rivlerësimit, kalimi i barrës së provës subjekteve të rivlerësimit për të justifikuar pasurinë, ndërkohë që ligji nuk e ka ngarkuar subjektin me detyrimin për të zbatuar masa të veçanta kujdesi, pikërisht për shkak se nuk bënte më parë pjesë në kategorinë e personave të dyshuar apo që duhej të justifikonin pronën, përbën dhunim të së drejtës për t’u mbrojtur, duke qenë se barra e provës i takon akuzës ose palës që ngre dyshimin. Subjekti pretendoi edhe se në vendimin e shkarkimit janë përdorur koncepte të paqarta dhe të papërcaktuara, të pasqaruara edhe nga ligji nr. 84/2016, të tilla si: “pasaktësi në deklarimin e burimeve financiare”, deklarim të pamjaftueshëm të të ardhurave”, “deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë”.

**19.3.** Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakui ankimi, trupi gjyqës konstatoi se parimet e përgjithshme të referuara nga subjekti i rivlerësimit në ankim, si të cenuara gjatë procesit të tij të rivlerësimit në Komision, i përkasin fushës së të drejtës penale dhe proceseve me karakter penal. Ndërkohë që, referuar dispozitave të Aneksit të Kushtetutës, të cilat përcaktojnë rregullat dhe parimet e zhvillimit të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ky proces ka natyrë administrative dhe jopenale. Për rrjedhojë, vlerësimi i gjetjeve nga hetimi administrativ në kuadër të vendimmarrjes së organeve të rivlerësimit dhe i tërë procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit, nuk i nënshtrohet standardeve të drejtësisë penale. Në këtë kontekst, pretendimet e subjektit të rivlerësimit për shkelje të nenit 7 të KEDNj-së, gjenden të pabazuara në ligj.

**19.4.** Sa u takon pretendimeve të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me çështjen e barrës së provës, trupi gjyqës çmoi se, referuar parashikimit të nenit Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, i cili përcakton shprehimisht: *Barra e provës i kalon subjektit të rivlerësimit vetëm për këtë proces, duke përjashtuar çdo proces tjetër, në veçanti procesin penal* - me kalimin e barrës së provës subjektit të rivlerësimit, lidhur me gjetjet e rezultuara nga procesi i hetimit administrativ, Komisioni nuk ka cenuar të drejtën e subjektit për t’u mbrojtur, por përkundrazi ka zbatuar me përpikëri procedurën e rivlerësimit kalimtar, sipas parashikimit kushtetues dhe atij ligjor.

---

<sup>9</sup> Subjekti duket që nënkupton ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**19.5.** Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për cenim të parimit të sigurisë juridike nëpërmjet përdorimit në vendimin e Komisionit të koncepteve të paqarta si “pasaktësi në deklarimin e burimeve financiare”, “deklarim të pamjaftueshëm të të ardhurave”, “deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë”, trupi gjykues çmon se, referuar edhe qëndrimin të mbajtur nga Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 2, datë 18.01.2017, lidhur me terminologjinë e paqartë të përdorur në ligjin nr. 84/2016, ku citohet: [...] është detyrë e gjykatave ose organeve të tjera shtetërore e shoqërore, të ngarkuara me ligj, që mangësi të caktuara të një ligji t’i plotësojnë natyrshëm përmes interpretimit dhe zbatimit të tij në praktikë [...], përdorimi nga Komisioni i koncepteve të sipërcituara dhe kuptimi i dhënë atyre në vendim janë objekt vlerësimi dhe kontrolli nga ana e Kolegjit, sipas shkaqeve konkrete të ankimit lidhur me kriterin e rivlerësimit të cilit i përkasin. Për rrjedhojë, vetëm fakti i përdorimit të këtyre togfjalëshave në vendimin e Komisionit, pa vlerësuar kontekstin në të cilin kanë gjetur përdorim, si dhe kuptimin që i ka dhënë Komisioni nëpërmjet arsytimit të tij, nuk vlerësohet i mjaftueshëm për t’u ngritur në nivelin e një shkak ligjor që mund të cenojë vlefshmërinë e vendimit të Komisionit. Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues e gjen të pabazuar në ligj shkakun e ankimit të subjektit të rivlerësimit për cenim të nenit 7 të KEDNj-së.

**19.6.** Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankimin e tij cenimin e nenit 8 të KEDNj-së, si pasojë e dhënies nga Komisioni të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, në shkelje të parimit të proporcionalitetit. Në mbështetje të këtij shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se si pasojë e masës së vendosur ndaj tij, ai ka humbur të gjitha shanset për të pasur një mundësi punësimi që përkon me kualifikimin dhe eksperiencën e tij profesionale. Subjekti pretendoi se nuk mund të ushtrojë për të gjithë jetën profesionin e gjyqtarit apo prokurorit, nuk mund të aplikojë për një detyrë a funksion në administratën publike, nuk mund të jetë noter apo ekspert i pavarur, si dhe nuk mund të marrë titullin avokat, madje, sipas tij, edhe ata që e kanë, mund t’u hiqet në ndonjë moment.

**19.7.** Në shqyrtim të këtij shkak ankimi, lidhur me vlerësimin nëse dhënia e masës disiplinore të shkarkimit të subjektit nga detyra përbën në vetvete cenim të nenit 8 të KEDNj-së, trupi gjykues mbajti në konsideratë trajtimin që i ka bërë Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut pretendimeve të kërkueses në çështjen Xhoxhaj kundër Shqipërisë, të ngjashme me këto të subjektit të rivlerësimit Edmond Hyka. Sipas GjEDNj-së<sup>10</sup>, për shkak të natyrës *sui generis* të procesit të rivlerësimit kalimtar dhe qëllimit për të cilin është miratuar ky proces, në përgjigje ndaj pranisë së perceptuar të korrupsionit të përhapur në sistemin e drejtësisë, është vlerësuar se pasja e një shkalle më të kufizuar sanksionesh është në përputhje me frymën e procesit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, dhënia e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra në kuadër të këtij procesi, nëse subjekti nuk arrin të përmbushë një nga tri kriteret rivlerësimit, është vlerësuar se nuk përbën shkelje të nenit 8 të Konventës. Më konkretisht, GjEDNj-ja ka arsyetuar: *Në të vërtetë, ligji nr. 84/2016 parashikon dy lloje sanksionesh disiplinore: shkarkimin nga detyra ose pezullim me detyrimin për të ndjekur trajnimin e detyrueshëm. Gjykata ka konsideruar, ndër të tjera, se mungesa e një shkalle të përshtatshme sanksionesh për shkelje disiplinore mund të jetë në*

<sup>10</sup> Shih paragrafët 392-393 të këtij vendimi.

*kundërshtim me parimin e proporcionalitetit (shih Oleksandr Volkov, paragrafi 182). [...] Sidoqoftë, procesi i rivlerësimit ka natyrë sui generis, me gjithë ngjashmëritë që duket se ka me proceset e zakonshme disiplinore. Ai është miratuar në përgjigje të pranisë së perceptuar të korrupsionit të përhapur në sistemin e drejtësisë, në mënyrë që të largojë elementet e korruptuara dhe të ruajë pjesën e shëndetshme të sistemit. Në rrethanat e jashtëzakonshme që i paraprijnë miratimit të ligjit nr. 84/2016 [...], Gjykata konstaton se është në përputhje me frymën e procesit të rivlerësimit që të ketë një shkallë më të kufizuar sanksionesh, në rast se një person nuk arrin të përmbushë një nga tri kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 84/2016. 413. Gjykata vëren më tej se, sipas ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, shkarkimi i kërkueses nga detyra passjell një ndalim të përjetshëm për t'u rifutur në sistemin e drejtësisë. Në lidhje me këtë, Gjykata përsërit se gjyqtarët, dhe posaçërisht ata që zënë pozicione që sjellin një shkallë të lartë përgjegjësie, siç janë pozicionet në të cilat kërkuesja dëshiron të rifillojë punësimin, kanë një pjesë të pushtetit sovran të Shtetit. Ndalimi i përjetshëm i vendosur ndaj kërkueses dhe individëve të tjerë të shkarkuar, për shkak të shkeljeve të rënda etike, nuk është në kundërshtim ose në raport të zhdrejtë me objektivin legjitim të ndjekur nga Shteti për të siguruar integritetin e detyrës gjyqësore dhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë [...] Kjo është veçanërisht e tillë në kontekstin kombëtar të konsolidimit të vazhdueshëm të shtetit të së drejtës. 414. Duke pasur parasysh shkaqet e mësipërme, Gjykata vlerëson se nuk ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës në lidhje me shkarkimin nga detyra të kërkueses.*

**19.8.** Ndërkohë, sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se si pasojë e masës së shkarkimit nga detyra, ai ka humbur çdo mundësi punësimi që përkon me kualifikimin dhe eksperiencën e tij profesionale, duke përmendur këtu, ndër të tjera, edhe pamundësinë për të marrë titullin avokat, madje sipas tij edhe ata që e kanë mund t'u hiqet në ndonjë moment, trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të çështjes, si dhe vlerësoi legjislacionin e zbatueshëm në fuqi, e gjeti këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit të pabazuar në fakte dhe në ligj. Trupi gjykues arriti në këtë përfundim pasi konstatoi se subjekti i rivlerësimit e ka marrë titullin e avokatit, madje dhe e ka ushtruar këtë profesion të lirë në vitet 1999-2005. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit në rastin konkret, nuk i nënshtrohet ndalimit të parashikuar në nenin 13, pika 2, germa “e” e ligjit nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”<sup>11</sup>, i cili u referohet të gjithë atyre

<sup>11</sup> Neni 13, “Fitimi i titullit të avokatit”, i ligjit nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë” përcakton shprehimisht:

“1. E drejta për ushtrimin e profesionit të avokatit fillon nga momenti i fitimit të titullit profesional “Avokat”. Avokati, në çastin e fitimit të titullit profesional, pajiset nga Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë me “Certifikatën e avokatit”, e cila përfaqëson dokumentin themeltar të identifikimit të tij profesional. Certifikata e avokatit përmban të dhënat personale të avokatit dhe “Numrin e Identitetit Personal”. Numri i Identitetit Personal është unik dhe i patjetërsueshëm.

2. Të drejtën për të fituar titullin “Avokat” në Republikën e Shqipërisë e ka çdo shtetas shqiptar që plotëson kushtet e mëposhtme:

a) të ketë zotësi të plotë juridike për të vepruar;  
b) të ketë përfunduar programin e ciklit të dytë të studimeve universitare për drejtësi brenda vendit, ose diplomë të njësuar me të, apo të ketë përfunduar studimet universitare për drejtësi jashtë vendit, të njohur dhe njësuar sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë;  
c) të ketë kryer stazhin e kandidatit për avokat për një periudhë jo më pak se një vit pranë një avokati, që ushtron profesionin në Republikën e Shqipërisë dhe të ketë marrë vlerësim pozitiv prej tij;

që synojnë të fitojnë rishtazi titullin profesional “Avokat”. Në këto kushte, masa e shkarkimit nga detyra si pasojë e procesit të rivlerësimit, nuk sjell për subjektin e rivlerësimit në këtë rast asnjë pengesë në ushtrimin e profesionit të avokatit, sa kohë kjo masë disiplinore nuk cenon titullin profesional “Avokat”, të fituar sipas legjislacionit në fuqi. Trupi gjykues vëren se në të njëjtin konkluzion si më sipër, ka arritur edhe GjEDNj-ja në çështjen Xhoxhaj kundër Shqipërisë, tek është shprehur në lidhje me pretendimet e kërkuases në drejtim të ndalimit të përhershëm të ushtrimit të profesionit të avokatit, duke i gjetur ato të pabazuara<sup>12</sup>.

**19.9.** Në përfundim të sa më sipër, në referim edhe të jurisprudencës së GjEDNj-së, trupi gjykues e gjen shkaku e ankimit të subjektit të rivlerësimit për cenim të nenit 8 të KEDNj-së të pabazuar në fakte dhe në ligj.

**19.10.** Subjekti i rivlerësimit pretendoi në ankimin e tij se i gjithë procesi i rivlerësimit është i parregullt dhe në kundërshtim të hapur me Kushtetutën, KEDNj-në dhe normat e tjera të së Drejtës Ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë. Në mbështetje të këtij shkakut ankimi, subjekti i rivlerësimit parashtroi se, referuar parashikimeve të nenit A të Aneksit të Kushtetutës, i janë kufizuar të drejtat që lidhen me të drejtën për respektimin e jetës private, si dhe dispozitat që lidhen me barrën e provës, nenet 128, 131, nënparagrafi “F”, 135, 138, 140, 145, paragrafi 1, 147/a,

---

*ç) të ketë përfunduar me sukses programin e trajnimit fillestar pranë Shkollës së Avokatisë dhe të jetë pajisur me certifikatën përkatëse;*

*d) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë: i. për një vepër penale të kryer me dashje, për të cilën nuk është rehabilituar; ii. për një vepër penale të kryer me pakujdesi, për të cilën nuk është rehabilituar dhe që cenon figurën dhe integritetin e profesionit të avokatit, të përcaktuara në Statutin e Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë; iii. për një vepër penale të kryer me dashje, për të cilën është rehabilituar, kur vepra penale cenon figurën dhe integritetin e profesionit të avokatit, të përcaktuara në Statutin e Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë;*

*dh) të mos ketë marrë masën disiplinore të heqjes së titullit të avokatit me vendim të Komitetit Disiplinor, me përjashtim të rastit kur kjo masë disiplinore është shuar sipas nenit 49 të këtij ligji;*

*e) nuk është shkarkuar nga ushtrimi i detyrës ose funksionit publik, për arsye të integritetit etik, me vendim të organit kompetent, që ka marrë formë të prerë, me përjashtim të rasteve kur masa disiplinore është shuar sipas legjislacionit të posaçëm;*

*ë) të kalojë me sukses provimin kualifikues të avokatisë, sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj, në Statutin e Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë dhe në rregulloren përkatëse;*

*f) të paguajë tarifën e fitimit të titullit profesional “avokat”, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Përgjithshëm të Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë.*

**3. Të drejtën e fitimit të titullit të avokatit e ka edhe çdo shtetas i huaj që plotëson kushtet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, dhe që vërteton zotërimin e gjuhës shqipe me anë të një dokumenti të lëshuar nga autoritetet kompetente, sipas legjislacionit në fuqi.**

**4. Avokati që ka fituar titullin profesional “Avokat” përpara fillimit të ushtrimit të profesionit të avokatit, kryen betimin, sipas kësaj formule: “I vetëdijshëm për dinjitetin e profesionit ligjor dhe funksionit të tij shoqëror, betohem të respektoj Kushtetutën dhe të përmbush, me besnikëri, dinjitet dhe profesionalizëm detyrat e profesionit të avokatit për qëllime të mbrojtjes së të përfaqësuarit dhe respektimit të standardeve evropiane dhe të të drejtave të njeriut”.**

<sup>12</sup> GjEDNj-ja ka arsyetuar: Në lidhje me çështjen në fjalë, Gjykata vëren se proceset ishin të udhëhequra dhe përfunduan në zbatim të ligjit nr. 84/2016. Institucionet e rivlerësimit nuk morën asnjë vendim në lidhje me të drejtën e kërkuases për të ushtruar profesionin e avokatit; ata nuk bënë as ndonjë referencë, qoftë edhe në mënyrë të nënkuptuar, në dispozitat e ligjit për avokatinë. Për më shumë, kërkuësja pohoi se ajo kishte një licencë për të ushtruar profesionin e avokatit. Në këto rrethana, Gjykata vëren se ajo nuk mund të pretendojë të jetë viktimë e shkeljes së të drejtave të saj sipas nenit 8 të Konventës. 372. Fakti që kërkuësja pretendon se mund të bëhet viktimë e mundshme në të ardhmen për shkak të rrezikut të heqjes së së drejtës së avokatisë, në përputhje me ligjin për avokatinë (shih paragrafin 208 më lart), është thjesht një dyshim ose hamendësim nga ana e saj. [...]. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se, për rrethanat e çështjes në fjalë, ky pretendim është i papajtuësëm racione personae dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35, paragrafët 3 (a) dhe 4 të Konventës.

paragrafi 1, nënparagrafi “b”, 149/a, paragrafi 1, nënparagrafi “b” i Kushtetutës. Për rrjedhojë, sipas subjektit të rivlerësimit, Aneksi i Kushtetutës bie ndesh me parimet themelore kushtetuese dhe të drejtat themelore kushtetuese dhe, në këto kushte, nuk duhet të gjente zbatim në rastin konkret. Sipas subjektit të rivlerësimit, kufizimi i të drejtave të tij ka qenë joproporcional dhe në kundërshtim me kërkesat e nenit 17 të Kushtetutës. Ai theksoi se këto kufizime nuk janë të vlefshme as në kuptim të detyrimeve që ngarkojnë Republikën e Shqipërisë për nenet 1, 6, 7, 13, 14, 15, 18 dhe Protokollin nr. 12 të KEDNj-së, duke qenë se Shqipëria nuk ka njoftuar Këshillin e Evropës për derogimin nga garancitë e ofruara nga këto nene të Konventës, njëkohësisht me miratimin e ndryshimeve kushtetuese që përfshijnë edhe Aneksin e Kushtetutës.

**19.11.** Në shqyrtim të këtij shkakui ankimi, trupi gjykues vlerësoi se procesi i rivlerësimit i cili është ngritur me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit gjyqësor dhe rikthimi i besimit të publikut tek drejtësia, është një proces i parashikuar në rang kushtetues. Për rrjedhojë, Kolegji në kuadër të përcaktimit të nenit 179/b të Kushtetutës nuk ka kompetencë të vlerësojë në themel dispozitat e Aneksit të Kushtetutës të inkuorporuara në Kushtetutë me anë të një ligji rishikues, përveçse t’i zbatojë ato në mënyrë të drejtpërdrejtë, në kuadër të zhvillimit të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në këtë kuptim, shkakui i mësipërm i ankimit të subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar në ligj.

**19.12.** Lidhur me pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka cenuar parimin e barazisë para ligjit të subjekteve të rivlerësimit, si pasojë e zhvillimit të procesit të rivlerësimit kalimtar me standarde të dyfishta, duke qenë se për subjekte të tjera rivlerësimi, në raste të ngjashme me subjektin Edmond Hyka, ka vendosur konfirmimin e tyre dhe jo shkarkimin si në rastin objekt gjykimi, trupi gjykues konstatoi se ky pretendim është artikuluar në mënyrë sipërfaqësore pasi nuk është argumentuar apo evidentuar në ankim situata e ngjashme faktike dhe trajtimi i ndryshëm ligjor nga ana e Komisionit. Megjithatë, trupi gjykues çmon se, në çdo rast, një pretendim i tillë i subjekteve të rivlerësimit nuk mund të përbëjë *a priori* shkak për të konsideruar të padrejtë vendimin objekt shqyrtimi. Çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, bazuar në specifikat e gjendjes faktike të provuara nga gjykimi dhe në zbatimin e detyrës të ligjit për situatën konkrete faktike dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni. Një qëndrim i tillë i Kolegjit është tashmë i konsoliduar me vendimmarrje të mëparshme të tij.

**19.13.** Lidhur me shkakun e ankimit, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit në kundërshtim me parashikimet e nenit 61, pika 1, duke qenë se subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në kushtet e dyfishtë të pasurisë së ligjshme, si dhe në kundërshtim me parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në kushtet kur kjo dispozitë ligjore kërkon plotësimin në mënyrë kumulative dhe jo alternative të dy kritereve: pamjaftueshmërisë në kontrollin e figurës dhe pamjaftueshmërisë në vlerësimin e pasurisë, trupi gjykues sjell në vëmendje se tashmë Kolegji ka krijuar jurisprudencë të konsoliduar në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të parashikimit të nenit 61, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me raportin e pavarur që kanë këto dy dispozita në prodhimin e pasojës juridike të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Sikundër dhe sa i takon mënyrës së vlerësimit të

secilit kriter rivlerësimi (atij të pasurisë dhe pastërtisë së figurës), e cila është e pavarur dhe mund të çojë në mënyrë të pavarur në pasojat e parashikuara nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, nëse deklarimi i subjektit për secilin kriter objekt shqyrtimi vlerësohet i pamjaftueshëm. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në konkluzionin se ky pretendim është i pabazuar në ligj dhe nuk mund të përbëjë shkak për cenimin e vlefshmërisë së vendimit të Komisionit në drejtim të sa më sipër.

**19.14.** Subjekti i rivlerësimit pretendoi gjithashtu se Komisioni ka interpretuar në mënyrë të gabuar nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në drejtim të kuptimit të konceptit të deklarimit të pamjaftueshëm. Subjekti pretendoi se deklarimi vlerësohet i pamjaftueshëm nëse përmban një nga situatat e përcaktuara në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, të cilat për sa kohë sjellin të njëjtën pasojë, atë të parashikuar në nenin 61, pika 3 e të njëjtit ligj, që përbën shkak për shkarkimin e subjektit nga detyra, duhet të jenë në të njëjtin nivel rëndësie dhe provueshmërie, si dhe të përbëjnë sjellje të rëndë të subjektit të rivlerësimit të një niveli të njëjtë ose të përafërt. Subjekti, me sa më sipër parashtruar, pretendoi se mungesa e burimeve financiare për të justifikuar pasuritë (pika “b” e pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016) mund të përbëjë deklarim të pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, vetëm nëse është në atë nivel të rëndë shkeljeje, të krahasueshëm ose të barabartë me fshehjen e pasurisë (neni 33, pika 5, germa “c”), deklarimin e rremë (neni 33, pika 5, germa “ç”) ose situatën e konfliktit të interesit (neni 33, pika 5, germa “d”).

**19.15.** Lidhur me shkakun e mësipërm të ankimit, i cili ka të bëjë me interpretimin e konceptit të deklarimit të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3, vlerësuar ky në raport me konstatimet e procedurës së vlerësimit të pasurisë sipas nenit 33, pika 5 e të njëjtit ligj, trupi gjykues vëren se jurisprudenca e deritanishme e Kolegjit i ka dhënë përgjigje pretendimeve të tilla të subjekteve të rivlerësimit si të pabazuara në ligj, për sa kohë konstatimet e nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si situata të cilat mund ta vendosin subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, nuk vlerësohen në raport me njëra-tjetrën, por shihen si situata të pavarura, vlerësimi i të cilave në kuadër të prodhimit të pasojave të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, i nënshtrohet rast pas rasti parimit të proporcionalitetit.

**19.16.** Subjekti i rivlerësimit pretendoi në ankimin e tij cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 6 të KEDNj-së, si pasojë: (i) e mosrespektimit të parimit të gjykimit nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e krijuar me ligj; (ii) e cenimit të parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve; si dhe (iii) cenimit të parimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm.

**19.17.** Në mbështetje të këtij shkakut ankimi, sa i takon pretendimit lidhur me mosrespektimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e krijuar me ligj, subjekti i rivlerësimit parashtrroi sa vijon.

**19.17.1.** *Komisioni nuk përmbush standardin e vendosur nga GjEDNj-ja<sup>13</sup> në drejtim të 4 kritereve që përcaktojnë nëse një organ që vendos masa disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve përbën një gjykatë të pavarur dhe të paanshme, më konkretisht sa i takon:*

---

<sup>13</sup> Subjekti referon kriteret e përcaktuara nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në çështjen [Oleksandr Volkov v. Ukraine](#).

a) *Procedurës së caktimit të anëtarëve të organit disiplinor, dhënies së garancive ndaj presioneve të jashtme.* Lidhur me këtë kriter, subjekti pretendoi se komisioneret B. B. dhe Xh. P. janë klasifikuar fillimisht në listën e kandidatëve që nuk plotësonin kriteret formale dhe në vijim, pa asnjë shpjegim, kanë kaluar në listën e kandidatëve të cilët i plotësojnë këto kritere. Sipas subjektit të rivlerësimit, asnjë nga anëtarët e trupit gjykues nuk plotësonte kushtin e përcaktuar në germën “b” të nenit 6 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me kriterin e vjetërsisë në profesionet e përcaktuara shprehimisht në atë nen. Gjithashtu, dy prej anëtarëve të trupit gjykues, z. O. K. dhe znj. B. B., janë anëtarë të ekspozuar ndaj presionit politik<sup>14</sup>, pasi kanë qenë pjesë e organeve shtetërore. Gjithashtu, sipas subjektit të rivlerësimit, referuar procedurës së intervistimit të kandidatëve për komisionerë, rezultoi e qartë edhe përkatësia politike e relatorit të çështjes, z. O. K.

b) *Përfaqësimit thelbësor të komunitetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në përbërjen e organit disiplinor.* Referuar këtij kriteri, sipas subjektit të rivlerësimit, rezultoi që asnjë prej komisionerëve nuk vjen nga radhët e sistemit gjyqësor.

c) *Kohëzgjatjes së mandatit të anëtarëve.* Sipas subjektit të rivlerësimit, kohëzgjatja e limituar e mandatit të anëtarëve të organeve të *vettingut*, pa mundësi riemërimi apo zgjatjeje, i bën ata veçanërisht vulnerabël nga influencat politike apo qeveritare.

ç) *Shmangies së mbivendosjes së funksioneve të ndryshme.* Subjekti pretendoi se është cenuar haptazi parimi i gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme në kushtet kur i njëjti trup gjykues ka kryer hetimin e fakteve dhe ka dhënë vendimin lidhur me gjetjet e bëra nga ai vetë.

**19.17.2.** Subjekti pretendoi se Komisioni ka qenë paragjykues dhe se dëshmi e një vendimi paragjykues dhe të paramenduar është edhe fakti që në vendim dhe në relacion, përdoret shprehja “pasuri e paligjshme”, ndërkohë që duhej të përdorej shprehja “pasuri e pajustificuar”.

**19.17.3.** Subjekti pretendoi edhe se shifrat e parashtruara në vendim dhe analizat e Komisionit nuk përputhen me ato të nxjerra gjatë hetimit të kësaj çështjeje dhe, sipas subjektit, ka qenë objektivisht e pamundur që këto analiza dhe krahasime, edhe pse të paplota dhe në kundërshtim me provat, faktet dhe ligjin, të bëheshin brenda një nate dhe nga vetë trupa gjykuese, për më tepër pasi ishte mbyllur hetimi.

**19.17.4.** Subjekti pretendoi se mosbërja me dije e emrave të personave të cilët kanë bërë përlllogaritjet teknike, që sipas tij kërkojnë njohuri të thelluara dhe aftësitë e një eksperti të licencuar kontabël, eksperti vlerësues të pasurive të paluajtshme, e bën të pamundur verifikimin nga ana e subjektit të rivlerësimit nëse ekziston ndonjë pengesë ligjore në kuptim të nenit 30 të Kodit të Procedurave Administrative, apo kërkesave të tjera të legjislacionit në fuqi, për konfliktin e interesave, duke bërë të cenohet e drejta e subjektit për t’u gjykuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e krijuar me ligj.

**19.17.5.** Subjekti i rivlerësimit pretendoi që vendimi nuk është bazuar në provat e marra rregullisht në seancë, por në prova të marra në mënyrë të paligjshme dhe pasi ishte marrë vendimi, si dhe nuk është marrë *de facto* nga trupa gjykuese, por nga persona të tjerë, ose të paktën në prani të personave të tjerë. Subjekti pretendoi se trupi gjykues e ka dhënë vendimin në prani të personave

---

<sup>14</sup> Subjekti referon çështjen e GjEDNj-së [Denisov v. Ukraine 25.09.2018, para. 70.](#)



të tjerë, apo duke u konsultuar me persona të tjerë, pasi kishte përfunduar hetimin dhe ishte tërhequr për vendim.

**19.17.6.** Subjekti pretendoi se i është cenuar e drejta për proces të rregullt, pasi Komisioni nuk u ka dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve thelbësore të subjektit të parashtruara në prapësime, por edhe verbalisht gjatë seancës dëgjimore.

**19.17.7.** *Mosrespektimi i dispozitave procedurale nga ana e Komisionit demonstroi mospërmblidhjen e kriterëve të nenit 6 të KEDNj-së për t'u konsideruar "gjykatë".* Sa i takon këtij pretendimi, subjekti u shpreh se procedura e ndjekur nga Komisioni në drejtim të afateve shumë të shkurtra për t'u shprehur gjatë procedurës administrative, përveçse i ka cenuar të drejtën për të përgatitur një mbrojtje efektive, sidomos në periudhën e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, ka shkelur në mënyrë flagrante edhe ligjin mbi bazën e të cilit ajo duhej të funksiononte duke referuar këtu parashikimet e nenit 94 të Kodit të Procedurave Administrative, në lidhje me njoftimin e palëve mbi kërkesën e organit publik për t'u shprehur me shkrim<sup>15</sup>. Subjekti pretendoi se Komisioni i ka caktuar seancën dëgjimore menjëherë pasi ai paraqiti prapësimet dhe nuk mori kohën e nevojshme për t'i shqyrtuar ato, por sipas tij, në shenjë hakmarrje, e ka njoftuar atë për t'u paraqitur në seancë dëgjimore duke i dhënë kohë vetëm disa orë, ndërkohë që për arsyetimin e vendimit, sipas subjektit, Komisionit i është dashur 6 muaj kohë, në shkelje të hapur të ligjit nr. 84/2016.

**19.18.** Në mbështetje të shkakut të ankimit lidhur me cenimin e së drejtës së subjektit për proces të rregullt ligjor në kuadër të parashikimeve të nenit 6 të KEDNj-së, sa u takon pretendimeve lidhur me cenimin e parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, subjekti i rivlerësimit parashtrroi:

**19.18.1.** Trupi gjykues i Komisionit ka ftuar subjektin në seancë dëgjimore pa marrë në konsideratë provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim me nenin 179/b, pika 2 e Kushtetutës, nenet 45, 55 të ligjit nr. 84/2016, nenet 48, 59, 87, pika 2, germa "ç" e Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në kundërshtim me pikat 10 dhe 11 të aktit "Hapat proceduralë të unifikuar për rivlerësimin e subjekteve nga trupat gjykuese të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit", duke e kthyer seancën e datës 19.12.2019 në një seancë formale.

**19.18.2.** Subjektit nuk i është lënë kohë e mjaftueshme për të gjetur mbrojtës dhe për t'u përgatitur për seancën dëgjimore, si dhe nuk i janë marrë parasysh kërkesat (i) për t'i dhënë kohë shtesë deri në përfundim të gjendjes së fatkeqësisë natyrore që të riballafaqonte faktet dhe provat; dhe (ii) për riçeljen e hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e një ekspertimi krahasues me analizat

---

<sup>15</sup> Referuar ankimit të subjektit të rivlerësimit, neni 94 i Kodit të Procedurës Administrative ka parashikuar:

"1. Në ato raste kur organi që zhvillon procedurën hetimore vendos t'u kërkojë palëve të interesuara të shprehen me shkrim, palët njoftohen për të paraqitur letrën përkatëse përpara jo më pak se 10 ditësh.

2. Njoftimi duhet të përmbajë të gjithë informacionin e nevojshëm në mënyrë që palët e interesuara të kuptojnë se çfarë është e rëndësishme për marrjen e vendimit. Njoftimi duhet të përmbajë, gjithashtu kohën dhe vendin se ku mund të konsultohet dosja përkatëse.

3. Në përgjigjen e tyre, palët e interesuara mund të shprehen për ato çështje që përbëjnë objektin e procedimit, të kërkojnë marrjen e masave të tjera dhe të bashkëngjisin dokumente".

financiare, konkretisht atë që është pjesë e rezultateve të hetimit dhe atë të depozituar nga subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës nëpërmjet mbrojtësit të tij.

**19.18.3.** Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi efektive për të kundërshtuar vlerësimet e referuara nga relatori dhe nuk është paraqitur në seancë dëgjimore, sepse koha e dhënë nga Komisioni nuk e ka lejuar të paraqitet dhe se Komisioni ka refuzuar kërkesën e mbrojtësit për ta shtyrë seancën dëgjimore edhe pse koha e njoftimit ishte jashtëzakonisht e shkurtër, si dhe vendi ndodhej në gjendje të jashtëzakonshme për shkak të fatkeqësisë natyrore.

**19.18.4.** Komisioni nuk i ka bërë të ditur subjektit se nga cilat prova ka nxjerrë të dhënat apo konkluzionet e pasqyruara në raportin e rezultateve të hetimit dhe më pas në vendimin e arsyetuar. Subjekti pretendoi gjithashtu se akti (prova) mbi bazën e të cilit është prodhuar rezultati financiar, është i panjohur prej tij sepse nuk ka asnjë shpjegim se si janë përcaktuar të dhënat në tabelat financiare apo në relacionin/vendimin e Komisionit.

**19.19.** Në mbështetje të të njëjtit shkak ankimi për cenim të nenit 6 të KEDNj-së, sa i takon pretendimit lidhur me mosgjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm, subjekti i rivlerësimit pretendon se, referuar parashikimeve të legjislacionit në fuqi, mund të arrihet në një konkluzion se procesi i rivlerësimit për një subjekt duhet të kryhet brenda një afati tremujor, ndërkohë që procesi i tij i rivlerësimit ka filluar më datë 11.12.2019<sup>16</sup> dhe është thirrur për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore publike më datë 18.12.2019. Gjithashtu, subjekti pretendoi se në pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, përcaktohet se vendimi i Komisionit duhet të merret brenda një afati njëmuajor, ndërkohë që nga momenti i shpalljes së vendimit të Komisionit deri në njohjen me arsyetimin e plotë të tij kaluan gjashtë muaj.

**19.20.** Në shqyrtim të pretendimeve të mësipërme të subjektit të rivlerësimit, trupi gjyqës konstatoi dhe vlerësoi si vijon:

**19.20.1.** Sa u takon pretendimeve të parashtruara nga ana e subjektit të rivlerësimit në paragrafin 19.17.1.a, trupi gjyqës vlerëson se në referim të dispozitave kushtetuese të cilat përcaktojnë gamën e kompetencave të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, nuk përfshihet vlerësimi i plotësisht të kushteve dhe kritereve të zgjedhjes në detyrë të komisionerëve të Komisionit apo të ndonjë funksionari tjetër, brenda dhe/apo jashtë institucioneve të procesit të rivlerësimit kalimtar. Për rrjedhojë, pretendimi i ngritur në ankimin e subjektit të rivlerësimit përpara Kolegjit, për vlerësimin e përmbushjes apo jo të kritereve ligjore të zgjedhjes në detyrë të anëtarëve të trupit gjyqës që kanë shqyrtuar çështjen e rivlerësimit të subjektit ankues në Komision, në funksion të konstatimit të cenimit apo jo të parimit të pavarësisë dhe paanësisë së trupit gjyqës, vlerësohet i pabazuar në ligj. Një qëndrim i tillë konfirmohet edhe nga vendimmarrje të mëparshme të Kolegjit për pretendime të së njëjtës natyrë<sup>17</sup>. Trupi gjyqës çmon të evidentojë faktin se subjekti i rivlerësimit, përveç sa më sipër, nuk ka ngritur asnjë pretendim tjetër në drejtim të fakteve/situatave, ekzistenca e të cilave, referuar parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr. 84/2016, do

<sup>16</sup> Data rezulton të jetë gabim. Referuar akteve të fashikullit hetimi administrativ ka filluar më datë 22.11.2018.

<sup>17</sup> Shih vendimin e Kolegjit nr. 7/2020 (JR), 6/2021 (JR) etj.

të përbënte pengesë ligjore për pjesëmarrjen e këtyre komisionerëve në përbërjen e trupit gjykues që do të rivlerësonte subjektin e rivlerësimit Edmond Hyka. Sikundër nuk është pretenduar nga subjekti asnjë fakt apo rrethanë e cila dëshmon për shprehje njëanshmërie të këtyre anëtarëve të trupit gjykues, çka, referuar vlerësimit sipas qasjes subjektive<sup>18</sup>, për trupin gjykues nuk ka arsye të vihet në dyshim cenimi i paanësisë së Komisionit në rastin e vendimmarrjes objekt ankimi.

**19.20.2.** Sa i takon pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit, se mungesa në përbërje të Komisionit e anëtarëve me prejardhje profesionale nga sistemi gjyqësor, si dhe kohëzgjatja e mandatit të tyre cenojnë paanësinë dhe pavarësinë e trupave gjykuese të tij, referuar kriterëve të përcaktuara nga jurisprudenca e GjEDNj-së<sup>19</sup> për një organ disiplinor, me efekt cenimin e nenit 6 të KEDNj-së, trupi gjykues, në shqyrtimin e këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, mban në konsideratë faktin që Komisioni është ngritur nga Kushtetuta si një organ i pavarur dhe i paanshëm, i cili do të kryejë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, sipas një procedure e cila garanton respektimin e parimeve të procesit të rregullt dhe të drejtat themelore të subjekteve të rivlerësimit<sup>20</sup>. Kriteret e zgjedhjes në detyrë të komisionerëve janë përcaktuar në ligjin nr. 84/2016, ku referuar parashikimeve të nenit 6, pika 1, germa “ë” e ligjit, bie në sy fakti se qenia gjyqtar apo prokuror gjatë dy viteve të fundit para kandidimit, përcaktohet si kriter përjashtues në vlerësimin e kandidaturave për t’u zgjedhur komisionerë. Për më tepër, vlen të theksohet fakti që ligji nr. 84/2016 i është nënshtruar kontrollit mbi kushtetutshmërinë e tij nga Gjykata Kushtetuese, e cila në vendimin e saj nr. 2, datë 18.01.2017, ka arsyetuar: *Për nga mënyra se si është konceptuar i gjithë sistemi i rivlerësimit në Kushtetutë, pra organet që e kryejnë atë, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të tyre dhe garancitë që ata gëzojnë, kompetencat që këto organe ofrojnë të gjitha garancitë që kërkon e drejta për një proces të rregullt gjyqësor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së. Gjykata ka theksuar se me qëllim që të përcaktohet nëse një organ është “i pavarur” ndër të tjera, duhet konsideruar mënyra e emërimit të anëtarëve të tij, si dhe kohëzgjatja e funksionit të tyre. Garancia e kohëzgjatjes dhe paprekshmërisë së mandatit e mbron gjyqtarin nga ndikimet e forcave politike që mund të vijnë në pushtet [...]. Gjykata Kushtetuese gjatë kontrollit të ushtruar prej saj në kuadër të vlerësimit të përputhshmërisë së parashikimeve të ligjit nr. 84/2016 me Kushtetutën, nuk ka konstatuar asnjë problematikë në drejtim të përbërjes së Komisionit, me efekt cenimin e parimit të pavarësisë dhe paanësisë.*

**19.20.3.** Duke përmbyllur analizën e mësipërme, trupi gjykues konstaton se një pretendim i tillë për cenim të parimit të pavarësisë dhe paanësisë së Komisionit, si pasojë e mungesës në përbërje të tij të anëtarëve të cilët vijnë nga sistemi gjyqësor, është trajtuar edhe nga GjEDNj-ja, e cila në vendimin e saj lidhur me çështjen gjyqësore Xhoxhaj k. Shqipërisë ka arsyetuar: *[...] Për sa i përket mospërfaqësimit të gjyqtarëve në detyrë në KPK, Gjykata në fakt ka theksuar nevojën për përfaqësim thelbësor të gjyqtarëve brenda organit përkatës disiplinor (shih Oleksandr Volkov, cituar më lart, paragrafi 109). Kjo nevojë është edhe më e rëndësishme në procedurat e zakonshme*

<sup>18</sup> Shih *Le Compte, Van Leuven dhe De Mevere kundër Belgjikës*, parag. 58; *Micallef kundër Maltës [GC]*, parag. 94.

<sup>19</sup> Subjekti referon në ankim vendimin e GjEDNj-së për çështjen Oleksandr Volkov v. Ukraine.

<sup>20</sup> Shih nenin 179/b, pikat 2, 5, 6, 8 dhe 10 të Aneksit të Kushtetutës.

*disiplinore kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve. Sidoqoftë, Gjykata duhet të marrë parasysh natyrën e posaçme të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri. Ky proces mori jetë në përgjigje të nevojës urgjente, siç vlerësohet nga legjislatura vendase, për të luftuar nivelin e lartë të korrupsionit që kishte pushtuar sistemin e drejtësisë. Ky proces përbëhet nga rivlerësimi i tri kritereve dhe ka për qëllim rivlerësimin e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë. Dhe është pikërisht kjo arsyeja që procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri është “sui generis” dhe duhet të dallohet nga çdo proces i zakonshëm disiplinor ndaj gjyqtarëve apo prokurorëve. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, fakti që anëtarët e KPK-së nuk vinin nga radhët e gjyqtarëve profesionistë në detyrë, ishte në përputhje me frymën dhe qëllimin e procesit të rivlerësimit, domethënë për të shmangur çdo konflikt individual interesi dhe për të siguruar besimin e publikut në këtë proces. Gjykata u referohet më tej kërkesave të rrepta të përzgjedhjes që anëtarët e KPK-së pritej të përmbushnin (shih paragrafin 123 më lart). Ajo vëren se këta anëtarë u përzgjedhën nga Parlamenti në përputhje me procedurën e përcaktuar me ligj (shih paragrafin 124 më lart). Për më tepër, statusi i anëtarëve të KPK-së është i njëjtë me atë të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë [...]. GjEDNj-ja në vijim ka arritur në konkluzionin se nuk gjen evidencë të mungesës së pavarësisë së Komisionit, si pasojë e mospasjes në përbërje të tij të anëtarëve që vijnë nga radhët e gjyqësorit, duke mos konstatuar për rrjedhojë, shkelje të nenit 6 të KEDNj-së lidhur me sa më sipër.*

**19.20.4.** Sa i takon shqyrtimit të pretendimit të subjektit të rivlerësimit se mbivendosja në të njëjtin trup gjykues e funksioneve të hetimit administrativ në lidhje me kriteret e rivlerësimit, çmimit të provave dhe vendimmarrjes lidhur me rivlerësimin kalimtar të tij, nuk përmbush standardin e gjykimit të çështjes nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, me pasojë cenimin e procesit të rregullt ligjor, trupi gjykues e vlerësoi këtë pretendim si të pabazuar në ligj. Trupi gjykues arriti në këtë përfundim pasi çmoi se veprimtaria e trupit gjykues të Komisionit, kompetencat e tij në kryerjen e procesit të rivlerësimit dhe mënyra e ushtrimit të tyre janë parashikuar shprehimisht në Kushtetutë dhe në ligjin nr. 84/2016, kontrolli i kushtetutshmërisë së të cilit është vlerësuar edhe nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 2, datë 18.01.2017. Trupi gjykues vëren se në të njëjtin konkluzion për moscenim të nenit 6, pika 1 e KEDNj-së, ka arritur edhe GjEDNj-ja në çështjen gjyqësore Xhoxhaj kundër Shqipërisë<sup>21</sup> në drejtim të vlerësimit të pretendimeve të ngjashme të kërkuases lidhur me cenimin e parimit të gjykatës së paanshme.

**19.20.5.** Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit parashtruar në paragrafin 19.17.2 më sipër në vendim, lidhur me përdorimin në vendimin e Komisionit të termit “pasuri e paligjshme” si tregues të një qëndrimi paragjykes të tij, trupi gjykues konstaton se rregullimi kushtetues lidhur me përcaktimin e qëllimit të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve referuar nenit D të Aneksit të tij, flet për pasuri të cilat nuk mund të justifikohen ligjërisht. Ndërkohë referuar nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës jepet edhe përkufizimi i konceptit “pasuri e ligjshme”, i cili për qëllimet e këtij ligji, përkufizohet në raport me të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Në kuptim të sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se përdorimi nga ana e Komisionit i terminologjisë “pasuri me burime jo të ligjshme” në të gjitha

<sup>21</sup> Shih paragrafët 307, 308 dhe 317 të të njëjtit vendim të GjEDNj-së.

rastet kur atij i ka rezultuar se subjekti nuk e ka justifikuar këtë pasuri me burime të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues dhe ligjor, nuk është korrekt, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në fuqi. Megjithatë kjo mënyrë jokorrekte të shprehuri nga ana e Komisionit në vendim, nuk është e mjaftueshme për të kualifikuar si paragjyquese sjelljen e Komisionit në shqyrtimin e këtij rasti rivlerësimi.

**19.20.6.** Sa u takon pretendimeve të ngritura nga ana e subjektit të rivlerësimit lidhur me mospërputhshmërinë e shifrave dhe analizave financiare të prezantuara subjektit të rivlerësimit, fillimisht në rezultatet e hetimit administrativ dhe në vazhdim në vendimin e arsyetuar, trupi gjykues, pasi kreu verifikimet e nevojshme nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, arriti në përfundimin se në analizat financiare të përgatitura nga ana e Komisionit në dokumentin “Rezultatet e hetimit administrativ”, krahasuar me analizat financiare të cilat pasqyrohen në vendimin e Komisionit objekt kontrolli, nuk vihen re mospërputhje të pajustificuara të shifrave. Trupi gjykues arriti në këtë përfundim pasi konstatoi se mospërputhja në zërat e analizës financiare përmbledhëse të periudhës 2005-2016 dhe në rezultatin e saj, nga varianti fillestar i paraqitur në “Rezultatet e hetimit administrativ” në variantin final të paraqitur në vendimin e Komisionit, vjen si rezultat i pasurimit të kësaj analize me zëra të rinj të ardhurash, të cilat, në përfundim të hetimit administrativ dhe pas vlerësimit të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, janë konsideruar nga ana e Komisionit me burim të ligjshëm, duke ndryshuar rezultatin fillestar të kësaj analize në favor të subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit në drejtim të sa më sipër u gjet i pabazuar në fakte.

**19.20.7.** Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se mosbërja me dije e emrave të personave të cilët kanë kryer përlllogaritjet financiare, e vë në kushtet e pamundësisë në vlerësimin e ekzistencës së rasteve të pengesës ligjore sipas parashikimeve të nenit 30 të Kodit të Procedurës Administrative, trupi gjykues konstaton se, referuar dispozitës së sipërcituar ligjore, nëpunësi publik i cili i nënshtrohet zbatimit të saj duhet të ketë/të ushtrojë kompetenca vendimmarrëse në procedurën administrative objekt kontrolli. Duke qenë se përlllogaritjet financiare kryhen nga këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor, e cila referuar parashikimeve të ligjit nr. 84/2016 nuk ka kompetenca vendimmarrëse në çështjet e rivlerësimit kalimtar dhe se analizat financiare të kryera prej saj jo vetëm i nënshtrohen debatit nga subjekti i rivlerësimit, në kuadër të parimit të kontradiktoritetit por dhe, në përfundim, lidhur me to vendos trupi gjykues dhe, për rrjedhojë, vlerësohet se nuk jemi para rastit të shkeljes së dispozitave ligjore lidhur me konfliktin e interesit. Për sa më sipër, edhe ky pretendim i subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar në ligj.

**19.20.8.** Sa u takon pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, sipas të cilave vendimi nuk është marrë bazuar në provat e marra rregullisht në seancë, apo është bazuar në prova të marra në mënyrë të paligjshme dhe pasi është marrë vendimi, trupi gjykues konstatoi fillimisht se subjekti nuk ka paraqitur prova të këtij fakti të pretenduar dhe, për më tepër, subjekti nuk i është referuar vlerësimit të ndonjë çështjeje apo pasurie konkrete, duke pamundësuar kontrollin e imtësishëm nga ana e trupit gjykues, me qëllim verifikimin e bazueshmërisë së këtij pretendimi. Megjithatë, nga verifikimi i kryer nga trupi gjykues në aktet e fashikullit të Komisionit, u konstatua se për disa kërkesa të Komisionit, drejtuar institucioneve të ndryshme shtetërore, përgjigjet kanë ardhur pas

datës së mbylljes së procedurës së hetimit administrativ më 10.12.2019. Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues, pasi verifikoi dokumentin e rezultateve të hetimeve dhe pjesët e vendimit të arsyetuar të cilat u takojnë trajtimit të pasurive objekt të kërkesave të sipërpërmendura, konstatoi se në vendimin e Komisionit nuk identifikohen akte/prova, të cilat t'i takojnë dokumentacionit të administruar pas mbylljes së hetimit administrativ apo informacioni i administruar pas mbylljes së hetimit administrativ të jetë përdorur për qëllim të vendimmarrjes së Komisionit. Për rrjedhojë, trupi gjykues arriti në përfundimin se nuk u provua pretendimi i subjektit të rivlerësimit që provat e administruara pas datës së mbylljes së hetimit administrativ të jenë përdorur me qëllim marrjen e vendimit nga Komisioni.

**19.20.9.** Lidhur me pretendimin e subjektit se trupi gjykues i Komisionit e ka dhënë vendimin në prani të personave të tjerë, apo duke u konsultuar me persona të tjerë, pasi kishte përfunduar hetimin dhe ishte tërhequr për vendim, trupi gjykues i Kolegjit, pasi kreu verifikimet e nevojshme në aktet e fashikullit të Komisionit konstatoi se, referuar procesverbalit të vendimmarrjes së Komisionit të datës 19.12.2019, ora 15:30 - 16:20, prezentë në diskutimet për marrjen e vendimit lidhur me rivlerësimin e subjektit Edmond Hyka, kanë qenë vetëm personat e autorizuar sipas parashikimeve të nenit 55, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte dhe në mungesë të sjelljes nga subjekti të fakteve që provojnë të kundërtën, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit në drejtim të sa më sipër, gjenden të pabazuara në fakte.

**19.20.10.** Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se atij i është cenuar e drejta për proces të rregullt, pasi Komisioni nuk u ka dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve thelbësore të tij të parashtruara në prapësime, por edhe verbalisht në seancën dëgjimore, trupi gjykues e ka të pamundur të verifikojë bazueshmërinë e këtij pretendimi, pasi konstatohet se subjekti nuk ka qenë konkret në parashtrimin e këtij pretendimi në ankim, për sa kohë nuk ka evidentuar se për cilat pretendime të tij thelbësore bëhet fjalë.

**19.20.11.** Sa u takon pretendimeve të subjektit të rivlerësimit të parashtruara në paragrafin 19.17.7 më sipër në vendim, në drejtim të shkeljes nga Komisioni të legjislacionit procedural të zbatueshëm dhe, për rrjedhojë, mospërmbushjes së kriterëve të nenit 6 të KEDNj-së për t'u vlerësuar si "gjykatë", trupi gjykues konstaton se dispozitat procedurale që referon subjekti i rivlerësimit, të cilat pretendohet të mos jenë zbatuar, janë neni 94 i Kodit të Procedurës Administrative dhe neni 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, lidhur me afatin e njoftimit të vendimit të arsyetuar pas shpalljes së tij. Në shqyrtim të këtij pretendimi, trupi gjykues vëren se neni 94 i Kodit të Procedurave Administrative nuk përbën mbështetje ligjore për situatën e pretenduar faktike, pasi kjo dispozitë ka të bëjë me rregullimin ligjor të procedurës administrative në rastin e tërheqjes së kërkesës apo braktisjes së procedurës nga subjekti. Ndërkohë, referuar përmbajtjes së cituar të kësaj dispozite, sipas tekstit në ankimin e paraqitur nga ana e subjektit të rivlerësimit, konstatohet se ky rregullim ligjor i përket Kodit të mëparshëm të Procedurave Administrative, të miratuar me ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999, i cili është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të kodit aktual, të miratuar me ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010. Referuar parashikimeve në fuqi, më konkretisht nenit 88 të Kodit të Procedurave Administrative: *E drejta e palës për t'u dëgjuar ushtrohet në çdo formë të përshatshme dhe brenda afatit të përcaktuar nga organi publik.* Në këtë kuptim, në rastin objekt

gjykimi nuk kemi të bëjmë me shkelje të procedurave ligjore nga ana e Komisionit. Sa i takon pretendimit për shkelje të parashikimeve të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, edhe pse rezulton që Komisioni ka shkelur afatin e parashikuar në këtë dispozitë, si pasojë e arsytimit të vendimit përtej afatit ligjor prej 30 ditësh, në vlerësim të trupit gjykues kjo shkelje nuk përbën shkak për të vlerësuar cenimin e nenit 6 të KEDNj-së në drejtim të nocionit të “gjykatës”.

**19.20.12.** Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues vlerëson se nuk jemi para rastit të cenimit të nenit 6 në drejtim të nocionit të “gjykatës”, sikundër pretendon subjekti në ankimin e tij.

**19.20.13.** Në lidhje me pretendimet e subjektit të rivlerësimit të parashtruara në të njëjtin paragraf, 19.17.7, më sipër në këtë vendim, trupi gjykues pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes lidhur me afatet kohore brenda të cilave duhej të përgjigjej subjekti i rivlerësimit gjatë procedurës administrative në Komision, konstatoi si më poshtë.

- (i) Më datë 22 nëntor 2019, ora 16:32, subjektit i është dërguar nëpërmjet *e-mail*-it Pyetëtori nr. 2 i Komisioni, me 23 pyetje dhe i është kërkuar përcjellja e përgjigjeve, si dhe e dokumentacionit justifikues ligjor, brenda datës 26.11.2019, ora 16:30.
- (ii) Subjekti i rivlerësimit në datën 25 nëntor 2019, ora 14:10, ka komunikuar me Komisionin dhe është shprehur: *Sot sapo mora dijeni për mailin tuaj të datës 22.11.2019, me të cilin më kërkohet dokumentacioni justifikues ligjor, brenda datës 26.11.2019, brenda orës 16:30. Ju bëj me dije se këtë e-mail e lexova vetëm sot, pasi më njoftuat ju, për shkak se nga orët e para të ditës, kam qenë i angazhuar në gjykatë me masat e sigurimit. Maili juaj ka arritur në postën time elektronike zyrtare, ditën e premte, datë 22.11.2019, në orën 4:32 pm, moment kur unë nuk kam qenë në zyrë, për shkak të përfundimit të orarit zyrtar. Gjithashtu, për shkak se banoj në qytetin e Durrësit, gjatë ditëve të fundjavës, nuk kam pasur asnjë mundësi reale të shoh e-mail-in tim zyrtar. Në këto kushte, ju kërktoj brenda mundësive të më jepni një afat kohor më të gjatë për kthimin e përgjigjeve dhe sigurimin e akteve ligjore që ju kërkoni, që dhe unë të jem sa më i saktë para jush.*
- (iii) Më datë 27 nëntor 2019, ora 16:10, Komisioni ka pasur një tjetër komunikim me subjektin e rivlerësimit me përmbajtje: *I nderuar subjekti i rivlerësimit. Lutem gjeni në vijim pyetëtorin nr. 3. Përgjigjet tuaja dhe dokumentacioni justifikues për pyetëtorët 2 dhe 3 të dërgohen brenda datës 3.12.2019.*
- (iv) Në datën 2 dhjetor 2019, ora 16:00, Komisioni i ka dërguar një tjetër *e-mail* subjektit të rivlerësimit, me të cilin i kërkon: *Verifikoni nëse nga këto lëvizje keni pasur udhëtime pune, nga cili institucion janë mbuluar shpenzimet për këto udhëtime, si dhe dokumentacionin ligjor justifikues për mbulimin e këtyre shpenzimeve. Shikoni nëse nga këto lëvizje keni pasur udhëtime për të cilat shpenzimet janë mbuluar nga persona të tretë duke vënë në dispozicion dokumentacionin ligjor justifikues. [...] Përgjigjet tuaja të dërgohen deri në datën 03.12.2019.*

- (v) Më datë 10 dhjetor 2019, trupi gjykues ka marrë vendim për përfundimin e hetimit paraprak për subjektin e rivlerësimit dhe kalimin e barrës së provës lidhur me gjetjet e këtij hetimi. Nëpërmjet komunikimit me *e-mail-in* e datës 10.12.2019, ora 16:52, subjekti i rivlerësimit është njoftuar ndër të tjera edhe për dorëzimin e provave dhe shpjegimeve me shkrim brenda datës 17 dhjetor 2019, ora 16:00.
- (vi) Në shpjegimet e tij ndaj rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit është shprehur i indinjuar për afatet e shkurtra të lëna në dispozicion dhe kërkesat e vazhdueshme për të dhënë prova dhe shpjegime ndaj pyetjeve të vazhdueshme të Komisionit, i cili nuk mori parasysh tronditjen e madhe dhe situatën e krijuar nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, por nuk rezultoi të ketë bërë kërkesë të re për afat shtesë.
- (vii) Në datën 18.12.2019, trupi gjykues me anë të vendimit nr. 3, ka vendosur të caktojë seancën dëgjimore në datën 19.12.2019, ora 09:30.
- (viii) Gjatë seancës dëgjimore, më datë 19.12.2019, përfaqësuesi i subjektit të rivlerësimit i ka bërë Komisionit kërkesë për kohë shtesë për mbledhjen e dokumentacionit ligjor në kuadër të mbrojtjes, si dhe kërkesë për riçelje të hetimit administrativ. Trupi gjykues i Komisionit, me vendimin nr. 4, datë 19.12.2019, i ka rrëzuar të dyja kërkesat e sipërcituara me argumentin se këto kërkesa janë të përsëritura dhe se subjekti i rivlerësimit ka marrë 5 ditë kohë shtesë për plotësimin e dokumentacionit dhe se, në vijim të kësaj shtyrjeje afati, subjekti nuk rezultoi të ketë kërkuar sërish kohë. Trupi gjykues i Komisionit argumentoi gjithashtu se nga ana e përfaqësuesit të subjektit, nuk u parashtrua asnjë kërkim apo provë konkrete, e cila që e pamundur për t'u marrë për arsye të gjendjes së emergjencës e për të cilën do të legjitimohej dhënia e kohës shtesë.

**19.20.14.** Në analizë të fakteve dhe rrethanave të konstatuara si më sipër, trupi gjykues vëren se me të drejtë subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni i ka përcaktuar afate shumë të ngushta kohore, si dhe nuk duket të ketë marrë parasysh faktorë të tjerë të cilët rezultojnë të kenë qenë prezentë për shkak të tërmetit të ndodhur më datë 26 nëntor 2019 dhe pasojave që ai solli, qofshin këto të natyrës psiko-emocionale, të lidhura me subjektin e rivlerësimit si banor i qytetit të Durrësit<sup>22</sup>, apo të natyrës operationale/funksionale të lidhura me strukturat shtetërore dhe/apo private ku mund dhe duhej të drejtohej subjekti i rivlerësimit, me qëllim përmbushjen e detyrimit ligjor për të paraqitur dokumentacion justifikues, në lidhje me çështjet e ngritura nëpër pyetësorët e Komisionit. Trupi gjykues vëren se edhe pse Komisioni ka dhënë një shtyrje afati prej 5 ditësh, ky afat i shtyrë nuk u është atribuar kërkesave të mëparshme për të cilat subjekti kërkoi kohë shtesë, por vihet re që një pyetësor i ri është shtuar dhe kërkesa të tjera specifike lidhur me udhëtimet e subjektit të rivlerësimit, sipas sistemit TIMS, janë përfshirë brenda afatit të shtyrë. Trupi gjykues konstatoi gjithashtu se në afatin e shtyrë prej 5 ditësh, dy prej tyre rezultuan ditë feste kombëtare (28 dhe 29 nëntor 2019) dhe, për rrjedhojë, ditë pushimi zyrtar dhe dy ditët pasuese

<sup>22</sup> *Durrësi rezultoi të jetë një ndër dy qytetet e Republikës së Shqipërisë për të cilat u shpall gjendja e fatkeqësisë natyrore me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019, "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë".*



(30 nëntor dhe 1 dhjetor 2019) ditë pushimi javor (fundjavë) duke e bërë tërësisht të pamundur përplekjen e subjektit të rivlerësimit për të mbledhur dokumentacion provues nga institucionet publike dhe/apo private, në kuadër të nevojave të procesit të rivlerësimit, pa llogaritur këtu problematikat e shtuara si pasojë e tërmetit. Për më tepër, fakti që rregullisht komunikimet e Komisionit i janë dërguar subjektit përtej orarit zyrtar, u vlerësua nga trupi gjykues si një faktor shtesë në vonesën e marrjes dijeni nga ana e subjektit të rivlerësimit të kërkesave të Komisionit, sa kohë rezultoi që korrespondenca është mbajtur në adresat zyrtare, duke ndikuar kështu në zvogëlimin e kohës efektive në dispozicion të subjektit, për efekt të përgatitjes së shpjegimeve dhe mbledhjes së dokumentacionit justifikues ligjor.

**19.20.15.** Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues e gjeti tërësisht të pajustificuar sjelljen e Komisionit në drejtim të përcaktimit të afateve kohore, brenda të cilave subjekti do duhej të përmbushte detyrimet e tij ligjore në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar dhe, për rrjedhojë, e vlerëson të drejtë dhe të bazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit për cenim të së drejtës së tij për mbrojtje efektive, si pasojë e caktimit nga ana e Komisionit të afateve tërësisht të paarsyeshme. Kjo sjellje e Komisionit u vlerësua se ka cenuar në thelb të drejtën e subjektit për proces të rregullt ligjor dhe, si e tillë, u çmua nga trupi gjykues si shkelje e rëndë procedurale. Për rrjedhojë, trupi gjykues, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, në nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenin 51, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore publike, për t’i dhënë mundësinë subjektit të rivlerësimit Edmond Hyka të dëgjohet dhe të mbrohet lidhur me çështjen e tij para trupit gjykues të Kolegjit. Në këtë mënyrë, trupi gjykues zgjidhi të gjitha pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me shkeljet nga Komisioni të parimeve të përgjithshme në kuadër të procesit të rregullt ligjor, në kuptim të garantimit të së drejtës së subjektit të rivlerësimit për një mbrojtje efektive të çështjes së tij. Për rrjedhojë, trupi gjykues e çmon të panevojshëm arsyetimin në vijim të shkaqeve të ankimit të paraqitura në paragrafët 19.18.2 - 19.18.3, të cilat lidhen me cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor si pasojë e afateve të përcaktuara nga Komisioni.

**19.20.16.** Në shqyrtim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, parashtruar në paragrafin 19.18.1, më sipër në vendim, trupi gjykues, pas analizimit të përmbajtjes së dispozitave ligjore të sipërcituara nga ana e subjektit të rivlerësimit, konstatoi se mosreflektimi i shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit lidhur me rezultatin e hetimeve në relatin e relatorit gjatë seancës dëgjimore publike, nuk bie në kundërshtim me parashikimet e dispozitave të thirrura nga subjekti, në veçanti me nenin 48<sup>23</sup> të Kodit të Procedurave Administrative, për sa kohë vlerësimi i Komisionit lidhur me shpjegimet e dhëna nga ana e subjektit të rivlerësimit në formë të shkruar dhe verbalisht gjatë seancës dëgjimore, janë trajtuar në vendimin e arsyetuar, në një rubrikë të veçantë, “Qëndrimi i subjektit në lidhje me konstatimet e Komisionit”, lidhur me çdo pasuri të marrë në shqyrtim nga Komisioni. Seanca dëgjimore nuk mund të vlerësohet se ka qenë formale, për sa kohë subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet përfaqësuesit të tij me prokurë në rastin konkret, ka

---

<sup>23</sup> Neni 48 i Kodit të Procedurave Administrative përcakton: “Organi publik, në çdo rast është i detyruar të vlerësojë me shkrim mendimet dhe shpjegimet e të gjitha palëve të paraqitura, në përputhje me nenin 47 të këtij Kodi”.

pasur të drejtën dhe i është dhënë mundësia të kundërshtojë çdo gjetje të Komisionit të relatuar nga ana e relatorit të çështjes, të shpjegojë të gjitha faktet dhe provat e mbledhura në kuadër të kalimit të barrës së provës nga Komisioni, si dhe të parashtojë çdo kërkesë që ai ka vlerësuar në interes të mbrojtjes së të përfaqësuarit prej tij.

**19.20.17.** Ndërkohë, sa i takon pretendimit se procedura e ndjekur nga Komisioni bie ndesh me parashikimin e nenit 87, pika 2 e Kodit të Procedurave Administrative<sup>24</sup>, trupi gjykues, pasi kontrolloi procedurën e ndjekur nga Komisioni, konstatoi se ky pretendim është i pabazuar në fakte pasi Komisioni me komunikimin e bërë nëpërmjet *e-mail-it* të datës 10.12.2019, në vijim të vendimit nr. 2 të së njëjtës datë të trupit gjykues për përfundimin e hetimit paraprak, ka përmbushur pikërisht kërkesat e kësaj dispozite ligjore. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues i gjen pretendimet e mësipërme të subjektit të rivlerësimit të pabazuara në fakte dhe në ligj.

**19.20.18.** Sa i takon pretendimit të parashtruar nga subjekti në paragrafin 19.18.4 më sipër në vendim, trupi gjykues vëren fillimisht se subjekti i rivlerësimit nuk është konkret dhe nuk identifikon në mënyrë specifike konkluzionet e arritura nga Komisioni, për të cilat, sipas tij, edhe pse janë përfshirë në raportin e rezultateve të hetimit dhe më pas në vendimin përfundimtar, nuk i kanë bërë të ditur se mbi bazën e cilave prova është arritur në këto konkluzione, çka i pamundëson trupit gjykues kontrollin e posaçëm lidhur me verifikimin e këtyre pretendimeve. Megjithatë, në një vlerësim tërësor të procedurës së ndjekur nga Komisioni, nga shqyrtimi i përmbajtjes së dokumentit “Relacion mbi rezultatet paraprake të hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit Edmond Hyka”, si dhe i metodologjisë së përgatitjes së tij, evidentohet se rezultatet e hetimit janë bazuar në: (i) provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe Prokuroria e Përgjithshme; (ii) aktin përfundimtar të Kontrollit të ILDKPKI-së, DSIK-së dhe Prokurorisë së Përgjithshme; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni në dosje, të marra nga institucionet publike dhe private; (iv) pyetjet, pyetësorët dhe përgjigjet e subjektit lidhur me konstatimet e bëra nga Komisioni; (v) sugjerimet e vëzhguesit ndërkombëtar për rrethanat konkrete në procesin e rivlerësimit; (vi) çdo dokument që përbën mjet prove, sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016. Në vijim, në kontrollin e kryer për secilën pasuri, Komisioni, në rubrikën “Hetimi i kryer nga Komisioni”, ka evidentuar veprimet konkrete hetimore dhe ka cituar aktet e

---

<sup>24</sup> Neni 87, “Njoftimi dhe e drejta për t’u dëgjuar para marrjes së vendimit përfundimtar”, i Kodit të Procedurave Administrative përcakton shprehimisht:

“1. Përpara se të merret vendimi përfundimtar, organi publik, përveç rasteve të parashikuara nga neni 64, i këtij Kodi, njofton palën lidhur me të drejtën e saj për t’u dëgjuar.

2. Njoftimi, sipas pikës 1, të këtij neni, bëhet me shkrim, apo në një takim me palën, dhe përmban këto të dhëna:

a) organin publik që zhvillon procedurën dhe nëpunësin publik përgjegjës;

b) palët e përfshira;

c) informacion për të drejtën e inspektimit të dosjeve dhe zyrës dhe vendin ku kjo mund të ushtrohet;

ç) provat e administruara, rezultatet e hetimit, si dhe rezultatet e pritshme të procedurës administrative dhe motivimin përkatës;

d) informacionin për të drejtën e palës për t’u dëgjuar dhe mënyrën dhe afatin e ushtrimit të kësaj së drejte;

dh) datën e fillimit të procedurës dhe afatin kohor, brenda të cilit do të merret dhe njoftohet vendimi, në qoftë se një afat i tillë është i zbatueshëm.

3. Afati i parashikuar sipas shkronjës “dh” të pikës 2 të këtij neni, nëse nuk parashikohet nga ligji ose aktet nënligjore, përcaktohet nga organi publik, në përputhje me nenin 53 të këtij Kodi”.

administruara që kanë vlerë provuese, të cilat i janë nënshtruar analizës dhe në përfundim kanë çuar Komisionin në konkluzionet përkatëse. Për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit nuk gjendet i bazuar në fakte.

**19.20.19.** Në shqyrtim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, sa i takon mosgjykimin të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, trupi gjykues, pasi konsultoi legjislacionin e zbatueshëm në fuqi për kryerjen e procesit të rivlerësimit, konstatoi se në aktet ligjore në të cilat janë përcaktuar rregullat dhe parimet e kryerjes së procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk janë bërë parashikime specifike sa i takon afatit të kryerjes së këtij procesi. Pavarësisht sa më sipër, referuar parimeve të përgjithshme të sanksionuara në Kushtetutë dhe në ligjin nr. 84/2016, organet e rivlerësimit duhet të garantojnë një proces të rregullt ligjor dhe, për rrjedhojë, rivlerësimin e subjektit brenda një afati të arsyeshëm. Karakteri i arsyeshëm i kohëzgjatjes së një procedure, referuar jurisprudencës së GjEDNj-së, përcaktohet mbi bazën e kriterëve, si: kompleksiteti i çështjes, sjellja e subjektit dhe e autoriteteve, si dhe rëndësia e çështjes për të interesuarin. Në kuptim të sa më sipër, trupi gjykues çmon se për shkak të kompleksitetit të çështjeve të përfshira në procesin e rivlerësimit të subjektit Edmond Hyka, numrit të konsiderueshëm të pasurive të deklaruara nga subjekti dhe personat e lidhur me të, si dhe larmisë së tyre në lloje, zgjatja e procedurës së hetimit administrativ për një periudhë prej 1 viti e 1 muaj përbën një afat të arsyeshëm në kuadër të një procedure të hollësishme kontrolli, siç kërkohet në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar. Ndërkohë, sa i takon afatit të zbardhjes së arsytimit të vendimit, konstatohet se me të drejtë subjekti ka pretenduar se periudha prej 6 muajsh nga data e shpalljes së vendimit deri në njoftimin e tij subjekteve të procesit, ka shkelur afatin prej 30 ditësh të përcaktuar shprehimisht në nenin 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, por duke mbajtur në konsideratë kompleksitetin e çështjes, si dhe faktin që në kuadër të përshkallëzimit të masave mbrojtëse nga COVID-19, Komisioni ka kufizuar veprimtarinë e tij institucionale dhe, në këtë kontekst, ka pezulluar ndër të tjera edhe afatet e vendimeve<sup>25</sup>, trupi gjykues vlerëson se tejkalimi i afatit të arsytimit të vendimit në rrethanat e sipërcituara, nuk vlerësohet si cenim i afatit të arsyeshëm. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues e gjen të pambështetur në prova pretendimin e subjektit të rivlerësimit për cenim të nenit 6 të KEDNj-së në drejtim të mosgjykimin të çështjes brenda një afati të arsyeshëm.

*C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material*

20. *Lidhur me shkakun e ankimit për konkluzion të gabuar të Komisionit në vlerësimin e kriterit të pasurisë, si pasojë e mosmarrjes në konsideratë të pasurisë së fituar nga subjekti i rivlerësimit nga trashëgimia ligjore, pas largimit nga jeta të trashëgimlënësit, babait të tij, në vitin 2009, trupi gjykues konstatoi si vijon.*
21. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, ka arsyetuar në vendimin e tij lidhur me të ardhurat e krijuara nga prindërit e subjektit të rivlerësimit: *Komisioni, pasi analizoi*

<sup>25</sup> Shih në faqen zyrtare në internet të Komisionit, linkun: <https://kpk.al/njoftim-145/>.

*dokumentacionin e përcjellë nga subjekti, shpjegimet e dhëna prej tij pas dërgimit të barrës së provës në lidhje me burimin e ligjshëm të shumave prej 5.000.000 lekësh dhe 35.000 eurosh të trashëguara nga babai i tij I. H., vlerësoi se: (i) të ardhurat e përfituara nga aktiviteti tregtar i shtetases XH. H. në vitet 1992-1994; (ii) të ardhurat e përfituara nga qiraja nga shtetasja Xh. H., në shumën 27.000 USD, për periudhën 10.10.1994 - 9.10.1997, nuk janë marrë në konsideratë nga Komisioni; (iii) të ardhurat e përfituara nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor ku shtetasja Xh. H. ka përfiturat shumat 9.729 USD dhe 6.300 USD, me një total të ardhurash 16.029 USD, janë marrë në konsideratë si të ardhura të përfituara nga burime të ligjshme financiare; (iv) të ardhurat e përfituara nga shtetasja Xh. H., në shumën 400.000 lekë, nga shitja e dyqanit të saj, janë marrë në konsideratë si të ardhura të përfituara nga burime të ligjshme financiare; (v) të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurive, dyqan me sip. 20 m<sup>2</sup> dhe apartament me sip. 60 m<sup>2</sup> të shtetases Xh. H. - Komisioni i ka marrë në konsideratë si të ardhura të përfituara nga burime të ligjshme financiare vetëm ato të përfituara nga shitja e dyqanit; (vi) në lidhje me të ardhurat nga dëmshpërblimi, në shumën 2.143.491 lekë, sipas vendimit të gjykatave, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit provoi me dokumentacion ligjor përfitim të dëmshpërblimit [...]; (vii) në lidhje me të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në pronësi të shtetasit I. H., me vlerë 2.000.000 lekë sipas kontratës së shitblerjes, datë 17.09.2004, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit provoi me dokumentacion ligjor përfitim të kësaj shume, duke vënë në dispozicion kontratën e shitblerjes, datë 17.09.2004. Komisioni ka analizuar ligjshmërinë e burimeve dhe mundësinë financiare për krijimin e shumave të trashëguara, 5.000.000 lekë dhe 35.000 euro. Në përfundim të analizës për ligjshmërinë e të ardhurave që kanë shërbyer si burim krijimi për shumat 5.000.000 lekë dhe 35.000 euro, të trashëguara nga shtetasi I. H., subjekti ka provuar me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm vetëm të shumës 93.715 lekë, ndërsa shuma prej 9.707.235 lekësh është e trashëguar nga babai i subjektit e cila rezulton e krijuar nga burime jo të ligjshme financiare.*

22. Subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të shkakut të ngritur në ankim për kundërshtimin e vlerësimit që i ka bërë Komisioni pasurisë së tij të fituar si rrjedhojë e trashëgimisë, pretendoi se sa i takon burimit të të ardhurave të krijuara nga prindërit e tij ndër vite, të cilat justifikojnë vlerat e lëna trashëgimi, janë paraqitur prova të mjaftueshme dhe bindëse që i provojnë këto të ardhura si të ligjshme, më konkretisht: (i) të ardhurat e krijuara nga shitja e një apartamenti me sipërfaqe 60 m<sup>2</sup>, në vlerën e 1.000.000 lekëve, provuar kjo me kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie z. S. D., sjellë në cilësinë e provës bashkëlidhur ankimit; (ii) të ardhurat e krijuara nga pensionet e prindërve, provuar me dokumentacionin bashkëlidhur ankimit; (iii) të ardhurat e përfituara nga qiraja e dyqanit në pronësi të prindërve në periudhën 1992-1997; (iv) të ardhurat e përfituara nga vendimet gjyqësore (Xh. H.) të viteve 1999 dhe 2000, në vlerën prej 16.029 USD, të cilat nuk janë përllogaritur në mënyrë të saktë nga ana e Komisionit, si pasojë e përdorimit të kursit të gabuar të konvertimit të kësaj shume në monedhën vendase; (v) lidhur me të ardhurat e krijuara nga aktiviteti privat i prindërve gjatë viteve 1992-1994, subjekti pretendoi se ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive për të justifikuar me dokumentacion të ardhurat e krijuara në këtë periudhë dhe, për rrjedhojë, pretendoi zbatimin e parashikimit të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016; (vi) të ardhurat e krijuara nga interesat bankare të cilat nuk janë përllogaritur nga Komisioni.

23. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, duke marrë në analizë pretendimet e subjektit të rivlerësimit, vlerësuar këto në raport me aktet e administruara në fashikullin e Komisionit dhe arsyetimin e këtij të fundit në vendim, trupi gjykues, duke mbajtur në konsideratë që pasuria e subjektit e deklaruar me burim trashëgiminë nga i ati ka shërbyer si burim krijimi për pjesën më të madhe të pasurive të krijuara në vijim, në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, vlerësoi të domosdoshme në kuadër të këtij procesi rivlerësimi, verifikimin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklarimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me pasurinë e trashëguar nga i ati. Në kuadër të sa më sipër, trupi gjykues konstatoi si vijon.
24. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Banesë private me sip. trualli 308,5 m<sup>2</sup>, në emrin tim, regjistruar në hipotekë [...] trashëgimi nga babai dhe dhurim nga nëna e motrat (bashkëlidhur kontrata dhe aktet e dhurimit). Vlera monetare të trashëguara nga babai I. H. në shumën prej 5.000.000 (pesë milionë) lekësh dhe 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) euro, të cilën e vërtetoj me deklaratën noteriale të datës 12.10.2010.*
25. Referuar vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës nr. 11-2009-2592-1690, datë 09.06.2009, kjo gjykatë ka vendosur:  
*Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë për trashëgimlënësin I. H., [...] duke caktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë si vijon:*  
- Xh. H. - bashkëshortja;  
- Edmond Hyka - i biri;  
- T. M. (H.) - e bija;  
- D. Ç. (H.) - e bija.  
*Të gjithë trashëgimtarët do të trashëgojnë nga 1/4 pjesë e pasurisë së trashëgimlënësit dhe në po këto raporte do të mbartin dhe detyrimet ndaj pasurisë së tij.*
26. Më datë 12 mars 2010, deklaruesit Xh. H., T. M. (H.) dhe D. Ç. (H.) kanë nënshkruar para noteres M. Th. N., deklaratën noteriale me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., me anë të të së cilës kanë deklaruar:  
*Ne deklarueset Xh. H., D. Ç. dhe T. M. deklarojmë nën përgjegjësinë tonë, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë se:*  
*Z. I. H. para vdekjes dispononte pasurinë e paluajtshme dhe vlerat monetare të përcaktuara më poshtë:*
- *Shuma 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) euro, nga të cilat 10.000 euro kanë qenë të depozituara në Bankën Intesa San Paolo dhe 25.000 euro gjendje në shtëpi.*
  - *Shuma 5.000.000 (pesë milionë) lekë të depozituara në banka të ndryshme.*
  - *Banesë me vendndodhje në Durrës, lagjja {\*\*\*}, rruga "{\*\*\*}", e cila është në proces regjistrimi pranë ZVRPP Durrës.*
- Ne trashëgimtarët ligjorë të I. H., duke respektuar vullnetin e tij para vdekjes, deklarojmë se pasuria e paluajtshme - shtëpi banimi dhe vlerat monetare 35.000 euro dhe 5.000.000 lekë do t'i kalojmë në favor të z. Edmond Hyka, dhe ne nuk kemi asnjë pretendim për të drejtat e pronësisë mbi këto pasuri.*

27. Në deklaratën periodike të vitit 2009, të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit më datë 31 mars 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *Të trashëguara nga babai I. H. më dt. 12.02.2009, 5.000.000 lekë (pesë milionë), nga të cilat 1.500.000 i janë shtuar depozitës së bashkëshortes E., depozituar si bono thesari, dhe 35.000 euro, nga të cilat 11.000 euro janë depozituar në First Investment Bank në emrin tim e të vajzës, 3.000 euro po te kjo bankë në emrin tim dhe pjesa tjetër 21.000 euro cash [...].*
28. Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarive bankare në emër të babait të subjektit të rivlerësimit në momentin kur i ndjeri ka ndërruar jetë, rezulton se ai ka pasur likuiditete në sistemin bankar në emër të tij dhe të përbashkëta me persona të tjerë, konkretisht si më poshtë:
- Depozitë pranë Bankës Intesa San Paolo, në emër të I. H., në vlerën 10.000 euro, e cila sipas dokumentacionit të përcjellë nga kjo bankë, kuptohet se ka qenë gjendje depozite pranë saj, të paktën deri më datë dt. 08.10.2009.
  - Depozitë dyemërore pranë Bankës Alfa, në favor të I. dhe Edmond Hyka, në shumën 1.300.000 lekë, depozituar më datë 08.05.2008 dhe tërhequr nga subjekti i rivlerësimit në datën 01.06.2012.
  - Depozitë dyemërore pranë Bankës Intesa San Paolo, në favor të I. dhe Edmond Hyka, hapur në datën 27.09.2005, në shumën 3.000.000 lekë, dhe tërhequr nga subjekti i rivlerësimit në datën 30.09.2009, për t'u investuar në vijim në bono thesari pranë Fibank, në datën 30.09.2009, në vlerën 4.500.000 lekë.
  - Depozitë dyemërore në Raiffeisen Bank, në favor të Xh. ose I. H. (hapur në datën 12.01.2005 dhe me vlerë 27.049 USD në datën 16.01.2009). Kjo depozitë është tërhequr *cash* në datën 22.10.2009 dhe është depozituar në të njëjtën datë nga Xh. H. në Bankën Credins. Në vijim është tërhequr në datën 26.10.2011 dhe është derdhur në po të njëjtën datë në Union Bank në vlerën e konvertuar prej 22.000 eurosh. Kjo depozitë i ka kaluar djalit të subjektit të rivlerësimit G. H. në datën 26.12.2012, nëpërmjet transfertës së brendshme në të njëjtën bankë.
29. I pyetur nga Komisioni në pyetësorin nr. 2, lidhur me vënien në dispozicion të dokumentacionit ligjor që vërteton deklarin e nënës dhe motrave të subjektit të rivlerësimit, se shumat e trashëguara prej 5.000.000 lekësh dhe 35.000 eurosh kanë qenë të depozituara në banka të ndryshme, subjekti i rivlerësimit është përgjigjur: *Unë dokumentacionin që disponoja dhe kam marrë nga bankat e kam depozituar në deklarinimet e bëra për vetting-un. Unë konsideroj të futur në banka shumat e depozituara nga im atë në Alfa Bank, Intesa San Paolo Bank, në emrin e tij dhe timin. [...] Në Alfa Bank, shumë e depozituar më datë 08.05.2008, me vlerë 1.300.000 lekë. Në Bankën Amerikane të Shqipërisë shumë e depozituar më datë 02.04.2008, me vlerë 1.000.000 lekë dhe më datë 30.09.2008, me vlerë 4.100.000 lekë. Kjo shumë është e mbartur që nga data 27.09.2005.*
30. Lidhur me gjetjen e Komisionit në “Rezultatet e hetimit”, si vijon: *Duket se ka mospërputhje deklarimi në lidhje me disponimin e shumave të trashëguara nga babai, 5.000.000 lekë dhe 35.000 euro:*

- sipas dëshmisë së trashëgimisë dhe deklaratës noteriale, shuma prej 5.000.000 lekësh është disponuar në banka të ndryshme dhe shuma prej 35.000 eurosh është disponuar 10.000 euro në depozitë bankare në Intesa Sanpaolo Bank dhe 25.000 euro cash;
- ndërsa nga informacioni i përcjellë nga bankat rezulton se I. H. ka pasur të depozituara shumat 10.000 euro dhe 1.300.000 lekë

– subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e tij lidhur me sa më sipër, është shprehur: *Në lidhje me konstatimet e relacionit, konfirmoj që këto vlera monetare nuk kanë lidhje me vlerat monetare prej 3.000.000 lekësh, të deklaruara përpara fillimit të detyrës, por janë cash, të trashëguara nga babai. [...] Në deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., të dhurimit, si rrjedhojë e dëshmisë së trashëgimisë, termi i përdorur, “Shuma 5.000.000 lekë, të depozituara në banka të ndryshme”, u referohet dy depozitave që i kam pasur në emrin tim dhe të babait, pranë Bankës Intesa San Paolo rreth 4.200.000 lekë (të kaluar më vonë në investime bono thesari) dhe tek Alfa Bank 1.300.000 lekë. Pra, nga vdekja e babait, kam trashëguar vlerën monetare cash prej 5.000.000 lekësh dhe 35.000 euro, të cilat në vitin 2009, përpara deklaratës noteriale të mësipërme, i kam kaluar 1.500.000 lekë në depozitën në emër të bashkëshortes, 3.000.000 lekë gjendje cash dhe 21.000 euro përsëri gjendje cash, si dhe 14.000 euro te depozita në llogaritë e depozitave në emrin tim dhe të vajzës sime I.*

31. Subjekti i rivlerësimit, i pyetur në seancë gjyqësore nga trupi gjykues lidhur me dhënien e një shpjegimi përfundimtar sa i përket shumës prej 5.000.000 (pesë milionë) lekësh, të depozituara në banka të ndryshme, dhe nëse dispononte ndonjë informacion më të detajuar se çfarë kanë qenë këto shuma të shpërndara në banka të ndryshme, u përgjigj: *Kjo shumë ishte në banesën time në kohën që vdiq babai dhe më është dorëzuar nga nëna ime dhe persona të tjerë, për të cilën unë kisha dijeni [...] 2.500.000 (dy milionë e pesëqind mijë), me sa kujtoj, se ka kaluar dhe kohë e gjatë, i ka dorëzuar I. D., i cili punonte në Western Union në Plazh Durrës së bashku me babain. Por një pjesë kanë qenë në Alpha Bank, kur depozita kishte qenë në emrin tim dhe në emrin e babait, po unë e mora vesh kur tërhoqa lekët pasi mbaroi kontrata. Duke përmbledhur, subjekti deklaroi se gjendja cash prej 5.000.000 lekësh ndodhej në shtëpi dhe përbëhej nga gjendja cash që mbante i ati në shtëpi, shuma që solli ortaku i tij I. D. dhe tërheqja e kryer nga vetë subjekti i rivlerësimit në llogarinë e sipërcituar pranë Alpha Bank. Subjekti deklaroi gjithashtu para trupit gjykues se shuma prej 5.000.000 (pesë milionë) lekësh e deklaratës periodike të vitit 2009 dhe e deklaratës noteriale të nënës dhe motrave në 2010-ën, nuk kanë lidhje me shumën e deklaruar në vitin 2005 prej 3.000.000 (tre milionë) lekësh.*
32. Në analizë të fakteve dhe rrethanave si më sipër konstatuar, trupi gjykues arrin në përfundimin se si pasojë e deklarimeve të paplota të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në deklaratimet periodike ndër vite, lidhur me evidentimin e kalimit të shumave të trashëguara nga trashëgimlënësi në favor të subjektit të rivlerësimit, dhe mbi të gjitha, si rrjedhojë e shpjegimeve kontradiktore të dhëna gjatë procesit të rivlerësimit në Komision dhe para Kolegjit, lidhur me gjendjen e likuiditetit të deklaruar si të përfituar nga trashëgimia në vitin 2009: (i) në momentin e çeljes së trashëgimisë; (ii) në momentin e nënshkrimit të deklaratës noteriale prej nënës dhe motrave të subjektit të rivlerësimit në datën 12.03.2010; si dhe (iii) në momentin e deklarimit në deklaratën periodike të vitit 2009, të dorëzuar nga subjekti më datë 31.03.2010, por që i referohej

gjendjes së pasurive të deklaruara në datën 31.12.2009 – ishte e pamundur të verifikohet ekzistenca e këtyre likuiditeteve në momentin e deklarimit në deklaratën e interesave privatë periodikë të vitit 2009, në masën e pretenduar prej 35.000 eurosh dhe 5.000.000 lekësh, në gjendje *cash* në banesë. Për rrjedhojë, *duke mbajtur në konsideratë edhe qëndrimin konsistent të subjektit të rivlerësimit gjatë procesit në Komision, si dhe gjatë gjykimit në Kolegj se të ardhurat e tij administroheshin nga i ati dhe se ato janë bërë pjesë e të ardhurave familjare*, trupi gjykues vlerësoi të marrë në shqyrtim dhe të verifikojë mundësinë e prindërve të subjektit të rivlerësimit për të krijuar me burime të ligjshme shumat e deklaruara si të trashëguara nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2009. Në kuadër të kësaj analize, të kryer mbi bazën e vlerësimit të pretendimeve të ngritura nga subjekti i rivlerësimit dhe kontrollit të analizës së burimeve të ligjshme të prindërve të subjektit nga Komisioni, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.

33. Lidhur me pretendimin mbi të ardhurat e krijuara nga shitja e një apartamenti me sip. 60 m<sup>2</sup>, subjekti i bashkëlidhi ankimit të tij kontratën noteriale të shitblerjes së apartamentit në pronësi të nënës së tij Xh. H., me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14 janar 2004, para noterit publik M. Rr. Subjekti provoi para Kolegjit pamundësinë e tij për ta dorëzuar këtë provë në Komision gjatë periudhës së hetimit administrativ, për shkak se gjatë periudhës së gjendjes së fatkeqësisë natyrore si pasojë e tërmetit të ndodhur më datë 26 nëntor 2019, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës nuk funksiononte. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së kontratës së sipërcituar të shitblerjes së pasurisë së paluajtshme, e ëma e subjektit të rivlerësimit, znj. Xh. H., rezultoi të kishte shitur më datë 14.01.2004, apartamentin e banimit me nr. pasurie {\*\*\*}, me vendndodhje në lagjen {\*\*\*}, {\*\*\*}, Durrës, me sipërfaqe ndërtimore 60 m<sup>2</sup> me çmim 1.000.000 lekë. Të ardhurat e pretenduara nga ana e subjektit të rivlerësimit konfirmohen në masën e pretenduar prej tij, edhe referuar dokumentit të përcjellë bashkëlidhur ankimit dhe të lëshuar nga Drejtoria Vendore Durrës e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 19.06.2020, në përgjigje të kërkesës së subjektit të rivlerësimit, lidhur me statusin juridik të pasurive me nr. {\*\*\*} dhe nr. {\*\*\*}, ZK {\*\*\*}, Durrës. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit në drejtim të krijimit të këtyre të ardhurave, gjendet i drejtë dhe i bazuar në fakte dhe në ligj. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se këto të ardhura me burim të ligjshëm duhet të përfshihen në analizën e vlerësimit të burimeve të ligjshme të prindërve të subjektit të rivlerësimit për krijimin e pasurive të lëna trashëgim.
34. Sa u takon të ardhurave të prindërve të subjektit, të përfituara nga pensionet, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka depozituar së bashku me ankimin e tij, shkresën e Drejtorisë Rajonale Durrës, pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore<sup>26</sup>, me anë të së cilës vërtetohet se znj. Xh. H. ka përfitur pension pleqërie për periudhën 03.01.1993 deri më 31.12.2013, në masën e 1.899.352 lekëve. Ndërsa me shkresën e të njëjtës institucion, me nr. {\*\*\*} prot., datë 22.06.2020, vërtetohet se z. I. H. ka përfitur pension pleqërie në periudhën 01.10.1988 deri më 12.02.2009, në masën e 1.502.490 lekëve. Nga shqyrtimi i dokumentit “Rezultatet e hetimit”, u vu re se Komisioni nuk kishte paraqitur asnjë analizë konkrete të të ardhurave dhe shpenzimeve të prindërve të subjektit, nga ku subjekti i rivlerësimit do të mund të kuptonte që këto të ardhura nuk

<sup>26</sup> Me nr. {\*\*\*} prot., datë 22.06.2020.



ishin përfshirë në analizën e kryer nga Komisioni, në drejtim të vlerësimit të mundësisë së prindërve të tij për të krijuar kursimet e trashëguara në vitin 2009. Ndërkohë, një analizë e tillë paraqitet në përmbajtje të vendimit të arsyetuar të Komisionit. Për rrjedhojë, pasi trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk i kishte paraqitur aktet e sipërcituara më parë në Komision, jo për faj të tij, çmoi në vijim se këto akte përmbushin kriteret e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, për t'u pranuar si prova të reja në këtë proces gjyqësor dhe, rrjedhimisht, për t'u përfshirë në analizën financiare të vlerësimit të burimeve të ligjshme të prindërve të subjektit të rivlerësimit.

35. Sa u takon pretendimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me të ardhurat e përfituara nga e ëma e tij nga qiradhënia e dyqanit në periudhën 1992-1997, trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit lidhur me këtë çështje, konstatoi se znj. Xh. H. ka hyrë në marrëdhënie kontraktuale qiraje me z. G. K. Marrëdhënia e qirasë e nisur fillimisht me efekt nga 1 nëntor i vitit 1994, sipas kontratës noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., para noterit P. T., rezultoi të jetë ndryshuar për sa u takon kushteve thelbësore të qirasë, provuar ky fakt nga vendimi gjyqësor i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjes në kuadër të marrëdhënies së qirasë<sup>27</sup>. Referuar informacionit të dhënë nga organi tatimor, se: [...] *pas verifikimit në zyrën e Arshivës nuk ka dosje fizike të subjektit*<sup>28</sup> dhe nga të dhënat e kontabilitetit, Xh. H., me kod fiskal 580 146, për vitin 1996-1998, ka paguar tatim qiraje gjithsej shumën 316.194 lekë. Për vitin 1994 nuk ka pagesë qiraje dhe për periudhën 1992-1995 nuk ka informacion – trupi gjykues, ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, vlerëson se pavarësisht faktit se pagesa e tatimit të qirasë, sipas të dhënave të kontabilitetit pranë organit tatimor i atribuohet znj. Xh. H., me kod fiskal 580 146, në kuadër të aktivitetit tregtar të ushtruar prej saj, tatimi i paguar në lidhje me të ardhurat e realizuara nga dhënia me qira e pronës, në një vlerësim logjik të fakteve, i referohet marrëdhënies së qirasë me z. G. K., duke qenë se e ëma e subjektit aktivitetin tregtar e ka kryer në pronën e saj, për të cilën nuk ngarkohej me kosto qiraje. Për rrjedhojë, trupi gjykues arriti në përfundimin se në analizën e burimeve të ligjshme të të ardhurave të prindërve të subjektit të rivlerësimit, duhet të përlllogariten edhe vlerat korresponduese të qirasë së përfituar në raport me tatimin e paguar. Sipas përlllogaritjeve të kryera nga Njësia e Shërbimit Ligjor, të ardhurat e qirasë, sipas përcaktimeve të mësipërme, përlllogariten në vlerën e 1.371.384 lekëve.
36. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit u gjetën të drejta dhe të bazuara edhe lidhur me moskonvertimin e saktë të shumës prej 16.000 USD, i cili rezultoi të ishte kryer nga Komisioni mbi bazën e një kursi këmbimi që nuk përputhej me kursin mesatar zyrtar të këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë, në vitet përkatëse sipas vendimeve gjyqësore me anë të të cilave u përfituan këto shuma. Nga rillogaritja, rezultoi se vlera prej 635.669 lekësh që përbënte diferencën e munguar, si pasojë e përdorimit të kursit të gabuar në konvertimin e valutës në monedhën vendase, duhet t'i shtohet burimeve të ligjshme të prindërve të subjektit të rivlerësimit.

---

<sup>27</sup> Referojuni vendimit të Gjykatës së Rrethit Durrës nr. 906, datë 22.09.1999, me paditës znj. Xh. H., të paditur z. G. K. dhe objekt padie "Detyrimin e të paditurit të paguajë qiranë në masën 600 USD në muaj, për periudhën nëntor 1998 deri në gusht 1999 dhe kamatë vonësën sipas kontratës".

<sup>28</sup> I referohet znj. Xh. H., në cilësinë e subjektit tatimor.

37. Sa u takon pretendimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me të ardhurat e krijuara nga aktiviteti privat i prindërve të tij, trupi gjykues konstatoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për ushtrim aktiviteti privat nga e ëma e tij mbështetet vetëm nga fakti që sipas organit tatimor përgjegjës, znj. Xh. B. H. figuron e regjistruar si subjekt privat për periudhën 1992 deri në vitin 1999, por për të nuk ekziston dosja fizike e të dhënave. Nga të dhënat e kontabilitetit, referohet vetëm kodi fiskal me të cilin është regjistruar dhe të dhënat për pagesën e tatimit mbi qiranë për vitet 1996-1998, ndërkohë që për periudhën 1992-1995 (periudhë që përfshin kohën e aktivitetit privat të ushtruar prej saj, 1992-1994), organi tatimor shprehet se nuk ka informacion. Në kuadër të sa më sipër, trupi gjykues e gjen të bazuar konkluzionin e Komisionit për mospërlllogaritje të të ardhurave të krijuara nga ushtrimi i aktivitetit privat të së ëmës, për sa kohë nuk u arrit të provohet me dokumentacion niveli i këtyre të ardhurave. Trupi gjykues çmoi se ishte e pamundur të përlllogaritej nëpërmjet metodave alternative shuma e këtyre të ardhurave, sa kohë nuk u gjet asnjë e dhënë e dokumentuar, e cila të lidhej me ushtrimin e aktivitetit privat të pretenduar nga e ëma e subjektit të rivlerësimit dhe të mund të orientonte drejt një niveli të caktuar xhiroje vjetore.
38. Sa i takon pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit, për mosmarrjen në konsideratë në analizën financiare të kryer nga Komisioni të të ardhurave të krijuara nga interesat bankarë, si pasojë e depozitave të prindërve në Bankën e Kursimeve në vitet '90, trupi gjykues, pasi verifikoi mandatat bankare të paraqitura nga subjekti në cilësinë e provës së këtyre depozitave dhe interesave bankarë të pretenduar si të akumuluar, konstatoi se prindërit e subjektit të rivlerësimit, në periudhën 15.10.1997 – 02.02.1999 kanë tërhequr nga Banka e Kursimeve shumën prej 1.821.494 lekësh dhe kanë depozituar gjatë së njëjtës periudhë shumën prej 2.369.600 lekësh. Në kuadër të këtyre lëvizjeve, trupi gjykues e gjen alogjik pretendimin e subjektit të rivlerësimit se diferenca mes derdhjeve dhe tërheqjeve, sipas këtyre mandateve bankare, në masën e 815.260 lekëve (diferencë e cila pas verifikimeve të kryera në Kolegj, rezultoi në masën e 548.106 lekëve), përbën të ardhura nga interesat bankarë të akumuluar, sa kohë është më se evidente që kjo vlerë monetare është krijuar si pasojë e derdhjeve në llogari, të cilat rezultuan të jenë më të mëdha se tërheqjet e kryera. Për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se me të drejtë Komisioni nuk ka përfshirë në analizën e tij financiare të ardhura në formën e interesave bankarë në masën e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit.
39. Në konkluzion të analizës së mësipërme lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit në drejtim të burimeve të ligjshme të të ardhurave të prindërve të tij, trupi gjykues, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, kontrollloi analizën e kryer nga ana e Komisionit duke kryer njëkohësisht edhe përditësimin e zërave të analizës, sipas konkluzioneve të arritura më sipër. Nga verifikimi i kryer, rezultoi se të ardhurat e ligjshme të prindërve të subjektit të rivlerësimit u shtuan me 5.746.005 lekë. Për rrjedhojë, trupi gjykues konstaton se, referuar tabelës së analizës financiare të kryer nga Komisioni<sup>29</sup>, rritja e nivelit të të ardhurave të ligjshme të prindërve të subjektit të rivlerësimit do të përmirësonte rezultatin financiar të mundësisë së tyre për të kursyer, nga **93.715** lekë në **5.881.208** lekë.

---

<sup>29</sup> Paraqitur në faqet 10-11 të vendimit objekt kontrolli.

40. Megjithatë, gjatë kontrollit të ushtruar në Kolegj, u konstatua se Komisioni, në vlerësimin e pasurive të prindërve të subjektit të rivlerësimit, ndonëse e kishte përfshirë në tabelën përkatëse pasurinë “Depozitë, datë 19.01.2009, znj. Xh. H., në vlerë 27.049 USD”, në përlllogaritjen e vlerës totale të pasurive, rezultoi se vlerën e kësaj depozite gabimisht nuk e kishte përfshirë në mbledhjen matematikore. Për rrjedhojë, kjo pasaktësi në llogaritje rezultoi në paraqitjen e një vlere totale të pasurive të prindërve të subjektit të rivlerësimit, më të ulët nga sa rezulton nga përlllogaritja matematikore e tyre, duke sjellë për pasojë një rritje në mënyrë artificiale të mundësisë së tyre për të kursyer. Në këto kushte, trupi gjykues vëren se efekti i shtimit të të ardhurave të ligjshme të prindërve të subjektit të rivlerësimit nga analiza e mësipërme nuk shoqërohet me shtimin në të njëjtën masë të mundësisë së tyre për të kursyer, sa kohë efekti i përlllogaritjes së pasaktë të vlerës totale të pasurive të krijuara, do të rezultojë në pakësimin e mundësisë për të kursyer në të njëjtën vlerë me vlerën e kësaj depozite. Përfundimisht, nga kjo analizë e trupit gjykues, rezultoi se prindërit e subjektit të rivlerësimit mund të justifikonin me burime të ligjshme vetëm vlerën prej **3.339.143** lekësh ose ekuivalentin prej **25.926** eurosh<sup>30</sup> nga pasuritë e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike të vitit 2009, si kursime të prindërve të përfituara nëpërmjet trashëgimisë, në vlerën e **5.000.000** lekëve në gjendje *cash* dhe **35.000** eurove po në gjendje *cash*.
41. Për rrjedhojë, vlerësimi i mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të pasurive të krijuara në vijim nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në rastet kur të ardhurat nga trashëgimia janë deklaruar si burim për krijimin e tyre, do të kryhet mbi bazën e rezultatit të mësipërm. Në këtë kontekst, trupi gjykues çmoi të marrë në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me pasuritë e krijuara në rend kronologjik pas çeljes së trashëgimisë, të cilat janë deklaruar si të krijuara me burim, ndër të tjera, edhe të ardhurat nga trashëgimia, si më poshtë vijojnë.
- Depozitë në Bankën Kombëtare Tregtare në obligacione, me afat 2-vjeçar, në emër të personit të lidhur, znj E. H. (bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit), në vlerën e 4.500.000 lekëve, si dhe të ardhurat të përfituara nga interesat në shumën e **1.635.639** lekëve.
  - Depozitë në “Fibank”, në emër të personit të lidhur, znj. I. H., vajzës së subjektit të rivlerësimit, në shumën 17.000 euro.
  - Depozitë në Bankën Kombëtare Tregtare, dega Durrës, në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. E. H., në shumën **20.000** euro.
  - Pasuri e paluajtshme “apartament” me sip. 65 m<sup>2</sup>, në pronësi të personit të lidhur, z. G. H., djali i subjektit të rivlerësimit.
  - Likuiditeti në gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, në vlerën e 10.000 eurove dhe 100.000 lekëve.
42. Lidhur me këto pasuri, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni ka arritur në konkluzion të gabuar si pasojë e vlerësimit të gabuar që u ka bërë të ardhurave të prindërve, të cilat subjekti i ka përfituar në vitin 2009 nëpërmjet trashëgimisë.

---

<sup>30</sup> Konvertuar sipas kursit mesatar të Bankës së Shqipërisë për muajin shkurt 2009.

43. Nga kontrolli i ushtruar në Kolegj lidhur me krijimin e pasurive të sipërcituara, mbi bazën e kontrollit të burimeve të krijimit dhe verifikimit të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.

43.1. Sa i takon depozitës në Bankën Kombëtare Tregtare, e cila në momentin e deklarimit në deklaratën e pasurisë *vetting* kishte vlerën 4.500.000 lekë, Komisioni ka arritur në konkluzionin se: *i. Lidhur me këtë depozitë, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të provoi me dokumentacion burimin e ligjshëm të shumës 2.000.000 lekë, për rrjedhojë, të ardhurat nga interesat që janë gjeneruar nga kjo pjesë, janë të ardhura të ligjshme dhe janë marrë në analizë nga Komisioni.*

*ii. Nuk provoi me dokumentacion burimin e ligjshëm të shumës 1.500.000 lekë, për rrjedhojë, të ardhurat nga interesat që janë gjeneruar nga kjo pjesë, në shumën 452.142 lekë, janë të ardhura jo të ligjshme. Për këtë arsye, këto të ardhura nuk janë marrë në analizë nga Komisioni.*

*iii. Provoi me dokumentacion burimin e ligjshëm të shumës 730.312 lekë, për rrjedhojë, të ardhurat nga interesat që janë gjeneruar nga kjo pjesë, janë të ardhura të ligjshme dhe janë marrë në analizë nga Komisioni.*

43.2. Nga verifikimi i kryer në Kolegj, referuar lëvizjeve bankare lidhur me këtë depozitë, nga data e krijimit të saj deri në momentin e deklarimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, rezultoi se shuma prej 1.500.000 lekësh, e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike të vitit 2009, me burim të ardhurat nga trashëgimia, është depozituar fillimisht në Bankën Intesa San Paolo në datën 19.02.2009 dhe në vijim e gjithë depozita prej 3.500.000 lekësh, në vitin 2010 ka kaluar në Bankën Kombëtare Tregtare. Referuar konkluzioneve të arritura nga Kolegji në paragrafin 40, më sipër në këtë vendim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur mundësi të justifikojnë me burime të ligjshme shtimin e depozitës në Bankën Intesa San Paolo, në datën 19.02.2009, në shumën e 1.500.000 lekëve. Për rrjedhojë, edhe interesat e përfutur nga kjo shtesë e depozitës vlerësohen nga trupi gjykues me burime të ligjshme. Në konkluzion, përfundimi i arritur nga Komisioni për pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për depozitën në Bankën Kombëtare Tregtare në obligacione me afat 2-vjeçar, në emër të personit të lidhur, znj E. H. (bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit), në vlerën e 4.500.000 lekëve, si dhe për të ardhurat e përfutura nga interesat, gjendet i pabazuar në fakte.

43.3. Në lidhje me depozitën në “Fibank”, në emër të personit të lidhur, znj. I. H., Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj depozite, në shumën e 17.000 eurove, si pasojë e pamjaftueshmërisë së shumës së trashëguar nga babai i subjektit të rivlerësimit.

43.4. Nga verifikimet e kryera në Kolegj lidhur me krijimin e kësaj pasurie, rezulton se kjo depozitë është krijuar në datën 11.10.2010, si bashkim i dy depozitave ekzistuese, të hapura përkatësisht: (i) nga subjekti i rivlerësimit në datën 09.10.2009, në të njëjtën bankë, në vlerën e 3.000 eurove, me burim të deklaruar “të ardhurat nga trashëgimia e babait”; si dhe (ii) nga depozita dyemërore, e krijuar në të njëjtën datë, pranë së njëjtës bankë, në favor të subjektit të rivlerësimit dhe vajzës së tij, në vlerën e 11.000 eurove, me burim të deklaruar të “ardhurat nga trashëgimia e

babait”. Trupi gjykues vëren se në datën 09.10.2009, kur janë çelur dy depozitat pranë Fibank, në vlerën totale prej 14.000 eurosh, subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë pasur likuiditet të mundshëm, të mbetur pas shtimit të depozitës së bashkëshortes në datën 19.02.2009, vlerën prej 1.839.143 lekësh, konvertuar në monedhën euro, në vlerën e 14.280 eurove. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të mund të justifikonin me burime të ligjshme krijimin e këtyre dy depozitave, të cilat në momentin e deklaramit në deklaratën e pasurisë *vetting*, përfaqësojnë depozitën në emër të personit të lidhur, znj. I. H., në vlerën e 17.000 eurove.

44. Në vijim të analizës së mësipërme, trupi gjykues konstaton se gjendja e likuiditetit *cash* me burim trashëgimie, në dispozicion të subjektit të rivlerësimit pas çeljes së dy depozitave pranë Fibank si më sipër trajtuar, rezulton të jetë në vlerën e 280 eurove. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit konstatohet të ketë qenë në pamundësi për të krijuar me burime të ligjshme nga trashëgimia pasuritë e krijuara në vijim.

- *Depozitën në Bankën Kombëtare Tregtare, në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. E. H., në shumën 20.000 euro, e cila nuk justifikohet në tërësinë e saj.*
- *Blerjen e pasurisë së paluajtshme “apartament” me sip. 66,5 m<sup>2</sup>, në Durrës, në vlerën e 32.000 eurove, në pronësi të personit të lidhur, z. G. H. (djali i subjektit të rivlerësimit), e pajustificuar në masën e 8.000 eurove, të deklaruara me burim kursimet nga të ardhurat e trashëgimisë.*
- *Likuiditetin në gjendje cash jashtë sistemit bankar, në vlerën e 10.000 eurove dhe 100.000 lekëve, të pajustificuar me burime të ligjshme në tërësinë e tij.*

Në përfundim, pas kontrollit të kryer në Kolegj, pasuritë e sipërcituara rezultuan me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

45. *Lidhur me pasuritë e paluajtshme “apartament” me sipërfaqe 121 m<sup>2</sup> dhe “dyqan” me sip. 52,5 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në Durrës, për të cilat subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuara konkluzionet e Komisionit lidhur me krijimin e tyre, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.*
46. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni ka arsyetuar në vendimin e tij lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklaramit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e këtyre dy pasurive, ndër të tjera, si vijon: *Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e përcjellë nga ZVRPP-ja Durrës, dokumentacionin e depozituar nga subjekti, si dhe deklaramet e subjektit dhe përfaqësuesit të tij ligjor, arrin në konkluzionin se:*
- *subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë për sa i përket vitit të përfitimit të apartamentit dhe të dyqanit;*
  - *çmimi i blerjes së apartamentit nga subjekti, i pasqyruar në kontratën e shitblerjes datë 22.2.2005, prej 2.000.000 lekësh (16.528 lekë/m<sup>2</sup>) nuk krijon bindjen se është çmimi real i blerjes, pasi rezulton të jetë disa herë më i ulët krahasuar me çmimet referuese të EKB-së [...];*
  - *çmimi i blerjes, në vlerën 500.000 lekë, të dyqanit me sip. 52 m<sup>2</sup> (9.615 lekë/m<sup>2</sup>), nga subjekti, me kontratën e shitblerjes datë 8.5.2005, nuk krijon bindjen se është çmimi real i blerjes pasi rezulton të jetë shumë herë më i ulët krahasuar me çmimet referuese të EKB-së [...];*

- subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarin të pasaktë në lidhje me burimin e krijimit të të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit dhe dyqanit.

47. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar si të pabazuara konkluzionet e Komisionit lidhur me kontrollin e dy pasurive të mësipërme, “apartament banimi me sip. 121 m<sup>2</sup>” dhe dyqan me sip. 52,5 m<sup>2</sup>”. Në mbështetje të këtij shkaku ankimi, subjekti i rivlerësimit parashtroi si vijon.

47.1. Subjekti kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit për deklarin të pasaktë të këtyre pasurive sa i takon vitit të përfitimit të tyre dhe shpjegoi se këto pasuri janë poseduar *de-facto* më parë se të realizohet kontrata e shitblerjes dhe, për këtë arsye, në deklarinet e tij si vit i krijimit të këtyre pasurive është deklaruar “viti real i përfitimit të tyre”.

47.2. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të padrejtë vlerësimin e Komisionit lidhur me të ardhurat e realizuara prej tij si pasojë e ushtrimit të aktivitetit të avokatisë në periudhën 2000-2005, si dhe të gabuar mënyrën e përlllogaritjes së këtyre të ardhurave. Ai gjithashtu shprehet se në periudhën e viteve 2000-2005, ka pasur vakum ligjor në lidhje me deklarinin e të ardhurave dhe fitimit brenda fashës së të ardhurave të krijuara si subjekt biznes i vogël, për të cilën ka paguar tatim fiks për xhiron 2.000.000 lekë, duke nënkuptuar që nuk mund të penalizohet për deklarin të pasaktë të këtyre të ardhurave, të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e këtyre dy pasurive, për më tepër që nga analiza financiare e Komisionit, subjekti rezulton me burime të ligjshme, të mjaftueshme, për krijimin e pasurive të sipërcituara.

47.3. Lidhur me vlerën e këtyre pasurive, subjekti shprehet se ajo është përcaktuar me vullnet të lirë të palëve dhe është pasqyruar saktësisht dhe rregullisht në kontratë. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti shprehet se nuk ka pasur asnjë arsye për të deklaruar një vlerë të ndryshme në kontratë, sepse jo vetëm që në atë moment kohor subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë subjekt deklarues, por mbi të gjitha vendosja e një çmimi më të ulët do të rezultonte në disfavorin e tij, për shkak se në rast shitjeje të këtyre pasurive, tatimi që do të duhej të paguante, do të ishte më i lartë.

48. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, nga verifikimi i akteve të fashikullit të Komisionit, trupi gjykues konstatoi se në deklarinin për herë të parë sipas deklaratës së dorëzuar në ILDKPKI më datë 05.05.2005, në rubrikën përkatëse, me titull “Data, viti i krijimit të pasurive”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si vit krijimi të këtyre dy pasurive objekt kontrolli, vitin 2002, për të cilin pretendoi se është viti në të cilin ka filluar posedimi i këtyre dy sendeve të paluajtshme. Ndërkohë në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar se këto dy pasuri janë krijuar në vitin 2002, por ka deklaruar në kuadër të përshkrimit të pasurive, të dhënat e kontratave të shitblerjes së tyre, ndër to edhe datën e lidhjes së tyre që i korrespondon vitit 2005.

49. Në përgjigje të pyetjes së Komisionit në pyetësorin nr. 2, se përse në deklarinin për herë të parë subjekti ka deklaruar si vit krijimi të këtyre dy pasurive vitin 2002, ndërkohë që ato janë blerë në vitin 2005, subjekti është përgjigjur: [...] *në deklarinin e pasurisë në momentin e emërimit në detyrë, për vitin 2005, viti në të cilin kam filluar, kam sqaruar se në vitin 2002 kam blerë apartamentin nga zoti I. C., apartamenti në atë kohë nuk kishte përfunduar plotësisht dhe se nuk ishin bërë dokumentet hipotekore. Në vitin 2005, pasi nga z. I. C. u mor dokumenti hipotekor, është*

*hartuar edhe kontrata e shitjes me nr. rep. {\*\*\*}, nr. {\*\*\*} kol., datë 27.04.2005, pranë noteres M. N. dhe unë e kam pasqyruar në deklaram.*

*[...] Unë vlerën e dyqanit e kam paguar më përpara. Në vitin 2003, për dyqanin është perkujdesur babai im, pa ndonjë akt juridik të shkruar, ndërsa kontratën e kam bërë më pas, për shkak se në vitin 2005 u mor nga firma ndërtuese dokumenti hipotekor dhe u nënshkrua kontrata përfundimtare e shitjes në mars 2005 [...].*

50. Në analizë të fakteve dhe rrethanave të sa më sipër referuar, trupi gjykues vlerëson se mosdeklarimi i vitit të krijimit *de facto* të pasurive në deklaratën e pasurisë *vetting*, por deklarimi vetëm i vitit të krijimit *de jure* të tyre, në kushtet kur viti i krijimit *de facto* të pasurive është deklaruar në deklaratën për herë të parë në ILDKPKI, si dhe është konfirmuar gjatë procesit të rivlerësimit në sqarimet e dhëna në pyetësorët e Komisionit, nuk e bën deklaramin e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting* të pasaktë, por të paplotë. Kjo mungesë informacioni në deklaratën e pasurisë *vetting*, ka shtyrë Komisionin në adresimin e disa pyetjeve, në përgjigje të të cilave subjekti ka konfirmuar të dhënat e deklaruara që në deklaratën për herë të parë pranë ILDKPKI-së, si dhe ka sqaruar që në deklaratën e pasurisë *vetting* ka deklaruar datën e krijimit të pasurive, sipas aktit përkatës juridik. Në këtë kuptim, konkluzioni i Komisionit për deklaram të pasaktë të datës së krijimit të pasurive, nuk gjendet i mbështetur në fakte.
51. Gjatë shqyrtimit të pretendimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me të ardhurat e tij të krijuara nga ushtrimi i aktivitetit privat të avokatit, trupi gjykues konstatoi se vlerësimi i këtyre të ardhurave nga ana e Komisionit, është kryer bazuar në shkresën e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Durrës me nr. {\*\*\*} prot., datë 10.10.2019, në të cilën është specifikuar për çdo vit të aktivitetit të ushtruar nga subjekti i rivlerësimit, qarkullimi faktik i realizuar, përveç vitit 2003, për të cilin nuk ka deklarim. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se Komisioni ka vepruar drejt dhe bazuar në faktet e provuara gjatë hetimit administrativ. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit se për këtë periudhë, ka pasur vakum ligjor sa i takon deklaramin të fitimit brenda fashës së të ardhurave të krijuara si subjekt biznes i vogël, për të cilin ka paguar tatim fiks për xhiron 2.000.000 lekë, vlerësohen të pabazuara. Trupi gjykues vlerësoi se sa kohë që subjekti i rivlerësimit ka deklaruar një vlerë konkrete të qarkullimit të realizuar, fitimi për atë vit nuk mund të tejkalojë vlerën e qarkullimit nga e cila do duhet të mbulohen, përveç detyrimeve fiskale, edhe shpenzimet e biznesit. Për rrjedhojë, Komisioni vlerësohet të ketë vepruar drejt. Në kuadër të kësaj analize, trupi gjykues çmoi se shkresa e datës 22.06.2020, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për marrje informacioni lidhur me pjesëmarrjen në çështje gjyqësore, si dhe të gjitha vendimet gjyqësore të marra në përgjigje të saj dhe të dorëzuara në cilësinë e provës në Kolegj, shërbejnë vetëm në drejtim të të provuarit të faktit të ushtrimit të profesionit të avokatit, për periudhën në fjalë, por jo në drejtim të nivelit të të ardhurave të ligjshme, të vlerësuara këto sipas standardit të përcaktuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, të cilat nga kontrolli i ushtruar në Kolegj, rezultuan të jenë përllogaritur në mënyrë të drejtë dhe me saktësi nga ana e Komisionit. Në kuadër të trajtimit të të ardhurave me burim nga avokatia, trupi gjykues, pas verifikimeve të kryera nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, gjeti të drejtë dhe të bazuar edhe konkluzionin e Komisionit se këto të ardhura, pasi u përdorën për blerjen në vitin 2002 të apartamentit dhe dyqanit, rezultojnë të pamjaftueshme

për të krijuar në vitin 2005 depozitën e hapur pranë Bankës Intesa San Paolo, në vlerën e 3.000.000 lekëve, në emër të subjektit të rivlerësimit dhe babait të tij.

52. Sa i takon kundërshtimit nga subjekti i rivlerësimit të konkluzionit të Komisionit, lidhur me çmimin e ulët të shitblerjes së dy pasurive objekt kontrolli, trupi gjykues, pasi kreu verifikimet e nevojshme, konstatoi se, sikundër shprehet edhe Komisioni në vendimin e tij, çmimet e përcaktuara në kontratat e shitblerjeve të pasurive apartament banimi me sip. 121 m<sup>2</sup> dhe dyqan me sip 52,5 m<sup>2</sup> janë më të ulëta se çmimet referuese në tregun e lirë të apartamenteve, sipas EKB-së, për vitet e krijimit të këtyre pasurive. Megjithatë, duke mbajtur në konsideratë: (i) parashikimet e Kodit Civil<sup>31</sup> lidhur me lirinë kontraktore të palëve të përfshira në transaksionin e shitblerjes; (ii) faktin që gjatë hetimit administrativ, sikundër shprehet edhe Komisioni në vendim, është hetuar dhe nuk ka rezultuar që subjekti i rivlerësimit të ketë qenë në konflikt interesi me personat që shfaqen në cilësinë e shitësve të këtyre pasurive të paluajtshme<sup>32</sup>, as në vitin e krijimit 2002, as në kohën e lidhjes së kontratave të shitblerjes në vitin 2005; (iii) ashtu sikundër nuk rezultoi që të ketë pasur gjetje nga hetimi administrativ që të provojë se subjekti ka paguar efektivisht një vlerë më të lartë sesa deklaruar në kontratë – trupi gjykues, bazuar edhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit<sup>33</sup>, arriti në përfundimin se ky konkluzion i Komisionit nuk mund të sjellë pasoja konkrete në rezultatin përfundimtar të kontrollit të këtyre dy pasurive të paluajtshme, për më tepër që nga analiza financiare e kryer nga vetë Komisioni, subjekti paraqet rezultat financiar me tepricë pozitive në vitet e krijimit të këtyre dy pasurive.
53. *Lidhur me shkakun e ankimit për kundërshtimin si të pambështetur në ligj të konkluzionit të Komisionit, sipas të cilit ky i fundit nuk ka konsideruar si të ligjshme të ardhurat e përfituara nga marrëdhënia e qirasë së dyqanit me sip. 52,5 m<sup>2</sup> në Durrës, në periudhën 29.03.2007 - 28.03.2013 - 02.01.2016, duke qenë se subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion ligjor për të provuar pagimin e tatimit në burim për të ardhurat e përfituara nga marrëdhënia e qirasë për periudhën e sipërcituar nga qiradhënësi apo qiramarrësi, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se detyrimin ligjor për pagimin e tatimit mbi këto të ardhura, në kuadër të parashikimeve të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, e ka pasur pala qiramarrëse, në cilësinë e subjektit tatimpagues.*
54. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakui ankimi, pas verifikimit të akteve të fashikullit lidhur me marrëdhënien e qiradhënies objekt kontrolli, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e palës qiradhënëse, dhe z. D. K., në cilësinë e palës qiramarrëse, kanë lidhur më datë 29 mars 2007, një kontratë qiraje para noterit publik M. Rr., me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., me afat 5-vjeçar dhe pagesë vjetore fikse prej 200.000 lekësh si çmim qiraje. Referuar tekstit të kontratës, palët kanë dakordësuar: *Këtë lokal me snd. 52,5 m<sup>2</sup>, unë ia jap me qira shtetasit Dritan Koni për të ushtruar aktivitetin e tij privat, të licencuar, për një periudhë kohe 5 (pesë) vjet, duke filluar [...]. Pala qiramarrëse pranon që të shlyejë në mënyrë të njëanshme detyrimin me koeficientin*

<sup>31</sup> Shih nenin 660 të Kodit Civil.

<sup>32</sup> Shih faqen 7 dhe faqen 9 të vendimit të Komisionit.

<sup>33</sup> Shih parag. 19 të vendimit të Kolegjit nr. 11 (JR), datë 22.05.2019.



*10% të vlerës së qirasë mujore, si të ardhur nga qiraja në favor të llogarisë së degës Tatim Taksave Durrës dhe të detyrimit për m<sup>2</sup> të sipërfaqes së lokalit, si dhe taksat vendore për tabelën, pastrimin, reklamën në favor të llogarisë së Bashkisë Durrës.*

55. Të njëjtat palë kanë lidhur më datë 28 mars 2013, një tjetër kontratë qiraje para noterit publik M. Rr. me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., me afat 5-vjeçar dhe pagesë vjetore fikse prej 240.000 lekësh, e cila përmban të njëjtin formulim si në kontratën e sipërcituar, sa i takon objektit të saj dhe detyrimit për pagesën e detyrimit tatimor mbi të ardhurën nga qiraja në llogarinë e degës së Tatim Taksave Durrës.
56. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se, edhe pse në kontratat e sipërcituara të qirasë, është evidentuar fakti se objekti i jepet me qira z. D. K., me qëllim ushtrimin prej tij të aktivitetit privat të licencuar, marrëdhënia e qiradhënies është materializuar në një kontratë të lidhur mes dy individësh. Z. D. K. paraqitet si qiramarrës individ dhe jo qiramarrës subjekt tregtar, rast në të cilin ligji do ta ngarkonte me detyrimin e agjentit të mbajtjes së tatimit në burim. Pavarësisht se referuar tekstit të kontratës, palët duket se kanë rënë dakord që detyrimin për pagesën e tatimit mbi të ardhurën nga qiraja ta ketë qiramarrësi, referuar parashikimeve të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, ky është një detyrim ligjor që i lind përfituesit të të ardhurave, qiradhënësit, i cili duhej të sigurohej që ky detyrim i tij të përmbushej nëpërmjet përmbushjes së detyrimit kontraktor nga ana e qiramarrësit. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar qëndrimin e Komisionit për mosllogaritjen si të ligjshme të të ardhurave të deklaruar nga kjo marrëdhënie qiraje, sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk provoi se këto të ardhura përmbushin standardin e të ardhurave të ligjshme sipas përcaktimit të nenit D, pika 3 e Kushtetutës, në drejtim të pagesës së detyrimeve tatimore.
57. *Sa i takon shkakut të ankimit lidhur me kundërshtimin si të pabazuar në fakte dhe në ligj të konkluzionit të arritur nga ana e Komisionit për pasaktësi në deklaram, si rrjedhojë e mosdeklarimit në deklaratën periodike të vitit 2011, të trajtimit preferencial që ka të bëjë me shitblerjen e automjetit tip “Benz”, blerë sipas kontratës nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 21.11.2011, para noteres M. Ç., në vlerën e 10.200 eurove, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.*
58. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni ka arsyetuar në vendimin e tij lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklaramit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie: *Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e përcjellë nga DPSHTRR-ja, si dhe shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse dhe të plota. Referuar deklaramit të subjektit, zhvlerësimi i këtij automjeti konstatohet se ka ndodhur brenda 3 ditësh, në shumën 297.674 lekë, pa llogaritur edhe shpenzimet e transportit të automjetit nga shteti gjerman në Shqipëri, zhvlerësim i cili nuk ndodh në një situatë reale shitblerjeje për një periudhë kaq të shkurtër kohore. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar trajtimin preferencial në deklaratën e pasurisë të vitit 2011, që ka të bëjë me shitjen e automjetit nga shitësi subjektit të rivlerësimit, me një vlerë më të ulët se çmimi i blerjes + shpenzimet doganore dhe ato të transportit, duke sjellë pasaktësi në deklaram.*

59. Subjekti i rivlerësimit, shkakun e ngritur në ankim lidhur me kundërshtimin si të pabazuar në fakte dhe në ligj të konkluzionit të Komisionit për deklarim të pasaktë të kësaj pasurie në deklaratën periodike të vitit 2011, e mbështeti në argumentet si në vijim.

59.1. Subjekti pretendoi se e ka blerë automjetin sipas kontratës së shitjes dhe ka deklaruar saktësisht vlerën e automjetit. Ai pretendoi gjithashtu se as ai, as djali i tij, z. G. H., nuk kanë pasur mundësi objektive dhe as detyrimin subjektiv të dinin se sa ishte vlera e shpenzimeve apo vlera e paguar nga shitësi.

59.2. Automjeti, sipas subjektit të rivlerësimit, është blerë sipas çmimit të rënë dakord nga palët dhe nuk bëhet fjalë për përfitim të automjetit pa kundërshtim. Për rrjedhojë, sipas tij, nuk plotësohen as kriteret kumulative për ta vendosur subjektin në kushtet e trajtimit preferencial, sipas përcaktimeve të nenit 2 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.

59.3. Subjekti pretendoi se edhe në eventualitetin që ky do të përbënte një trajtim preferencial, nuk ka asnjë rubrikë në deklaratën *vetting* që të parashikojë një detyrim të tillë për deklarim dhe se, në kuadër të procesit të rivlerësimit, ai mban përgjegjësi për saktësinë dhe plotësinë e deklaratës *vetting*.

60. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjyqësor, pasi kontrollon vendimin e Komisionit lidhur me krijimin e pasurisë së luajtshme të llojit automjet, të blerë në vitin 2011, konstatoi se ky i fundit nuk ka arritur në konkluzionin se kjo pasuri e subjektit të rivlerësimit është krijuar në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, si pasojë e gjendjes së konfliktit të interesit apo në kuadër të deklarimit të rremë. Konkluzioni i Komisionit për pasaktësi në deklarim lidhur me këtë pasuri të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, konstatohet të jetë bazuar dhe t’i referohet vetëm pasaktësisë së deklarimit të kësaj pasurie në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, vit në të cilin është kryer blerja e automjetit nga subjekti i rivlerësimit.

61. Lidhur me sa më sipër, trupi gjyqësor çmoi se pasaktësia në deklarimin e automjetit në vitin 2011 (edhe nëse do të vlerësohej si e tillë) do mund të sillte efekte në kontrollin e kësaj pasurie dhe, për rrjedhojë, edhe në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë së subjektit, në kuadër të procesit të rivlerësimit, vetëm nëse kjo pasaktësi në deklarim do të shoqërohej me një nga situatat e përcaktuara në nenin 33, pika 5, gjerat “b” – “ç” të ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, trupi gjyqësor, duke mbajtur në konsideratë konkluzionin përfundimtar të Komisionit lidhur me këtë pasuri, si dhe faktin se gjatë hetimit administrativ në Komision nuk rezultoi të ketë pasur gjetje në drejtim të sa më sipër referuar, arrin në përfundimin se, edhe nëse do të provohej përfitimi i një trajtimi preferencial dhe mosdeklarimi i tij nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike të vitit 2011, duke e vendosur atë në kushtet e deklarimit të pasaktë në këtë deklaratë periodike, ky konkluzion nuk do të paraqiste relevancë në kontrollin e kësaj pasurie, për efekt të procesit të rivlerësimit.

62. Lidhur me shkakun e ankimit, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si pa efekt në kuadër të kontrollit të pasurisë së tij dhe rezultateve të kriterit të pasurisë konkluzionin e Komisionit se ai

“nuk ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me mosdeklarimin e shitjes dhe blerjes së automjeteve në vitin 2009, si dhe mosdeklarimin e çmimit të shitjes dhe blerjes së automjeteve në deklaratën e vitit 2011”, duke qenë se sipas tij këto pasaktësi të konstatuara nga Komisioni, përveçse nuk lidhen me deklaratën e pasurisë *vetting*, nuk sjellin asnjë efekt në pasuritë e deklaruara në këtë deklaratë, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të Komisionit, konstatoi se Komisioni me të drejtë i ka vlerësuar këto situata si mosrespektim të detyrimit ligjor për deklarim të saktë dhe në përputhje me ligjin të pasurive në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të. Pasaktësitë në deklarimet periodike lidhur me sa më sipër, i pranon në ankimin e tij edhe subjekti i rivlerësimit. Megjithatë, sikundër trajtuar edhe më sipër në vendim lidhur me automjetin e markës “Mercedes Benz”, tipi 211 E280 CDI, trupi gjykues vlerësoi se konkluzioni për pasaktësi në deklarimet periodike të këtyre automjeteve pranë ILDKPKI-së do të merrte vlerë në vlerësimin e kriterit të pasurisë, në kuadër të procesit të rivlerësimit nëse pasaktësitë e evidentuara do të shoqëroheshin apo do të shërbenin si mjete për ta vendosur subjektin e rivlerësimit në një nga situatat e përcaktuara në nenin 33, pika 5, gjerat “b” – “ç” të ligjit nr. 84/2016. Në kushtet kur Komisioni nuk ka bërë asnjë gjetje në drejtim të sa më sipër, trupi gjykues çmon se pasaktësia e konstatuar nga Komisioni, nuk merr vlerë në kuadër të procesit të rivlerësimit, për sa kohë nuk mund ta kualifikojë deklarimin e subjektit lidhur me këto pasuri si deklarim të pamjaftueshëm.

#### *D. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e aftësive profesionale*

63. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar konkluzionin e Komisionit, lidhur me mosdeklarimin e heqjes dorë në çështjen penale me palë shtetasin I. Ç. Subjekti i rivlerësimit u shpreh në ankim dhe gjatë seancës gjyqësore në Kolegj se, pavarësisht se ky konkluzion nuk ka shërbyer si shkak shkarkimi nga ana e Komisionit, ai kundërshtohet prej tij si i pabazuar në ligj, pasi subjekti pretendon të mos jetë ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit, referuar parashikimeve të nenit 26 të lidhura me nenet 15, 16, 17 të Kodit të Procedurës Penale, për t'i lindur detyrimi për heqjen dorë nga ushtrimi i funksionit të prokurorit.
64. Komisioni, lidhur me papajtueshmërinë apo situatën e konfliktit të interesit me funksionin e prokurorit të subjektit të rivlerësimit dhe z. I. Ç., në lidhje me çështjen penale me kërkues z. Çepani, me objekt “kundërshtimin e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. {\*\*\*}, të vitit 2011, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga prokurori Edmond Hyka, datë 20.03.2018, në Gjykatën e Apelit Tiranë, ka arsyetuar në vendim si vijon: [...] *Kodi i Procedurës Penale, në nenin 26, parashikon “heqjen dorë të prokurorit”, i cili në pikën 1, përcakton se prokurori ka për detyrë të heqë dorë kur ekzistojnë arsye njëanësie për rastet e parashikuara nga neni 17. Neni 17 i Kodit të Procedurës Penale, “Heqja dorë e gjyqtarit”, e cila është e njëjtë dhe me atë të prokurorit në germën “ë” të tij, e lidh dorëheqjen me rastin e “ekzistencës së shkaqeve të tjera të rëndësishme të njëanshmërisë”. Në rastin konkret, ekzistojnë rrethanat ku subjekti i rivlerësimit ka qenë në një situatë, marrëdhënie interesi, me palët pjesë të atij procesi, çështje e cila i ishte caktuar me short subjektit të rivlerësimit. Subjekti Edmond Hyka ka konfirmuar marrëdhënien me shtetasin I. Ç. nga viti 2002 deri në vitin 2005, duke finalizuar kështu dhe*

*veprimin e shitblerjes së apartamentit. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit ka qenë në pamundësi objektive për të ushtruar funksionet e tij si prokuror dhe duhej të kishte deklaruar heqjen dorë nga kjo çështje, ku palë ishte shtetasi I. Ç. Pavarësisht pretendimit që ngre subjekti, që roli i tij ka qenë pothuaj i zbehur dhe gjykata ka vendosur në disfavor të tij, praktika juridike nuk e lidh këtë fakt me ushtrimin e ndikimit ose jo, apo me qëndrimin pro apo kundër të subjektit ndaj palës me të cilën ka pasur një marrëdhënie, por rezulton se vetëm fakti i qenies pjesë e një procesi me një palë ku ka ekzistuar një marrëdhënie, në rastin konkret interesi, do të ishte e mjaftueshme që subjekti, në zbatim të ligjit, të jepte dorëheqjen. Në bazë të nenit 26 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti Edmond Hyka, që në momentin e caktimit me short të dosjes me palë shtetasin I. Ç., duhej të kishte kërkuar heqjen dorë nga kjo çështje, kërkesë kjo drejtuar drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Tiranë, edhe pa shprehur qëndrimin e tij në këtë çështje. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrat e tij procedurale për sa i përket heqjes dorë apo deklarimit të papajtueshmërisë së ushtrimit të detyrës së tij, të prokurorit, në çështjen në fjalë, si pjesë e rëndësishme e etikës së magjistratit.*

65. Në shqyrtim të këtij shkak ankimi, trupi gjykues vëren se konkluzioni i kundërshtuar i Komisionit, për mospërmbushje nga ana e subjektit të rivlerësimit të detyrimit ligjor për heqje dorë apo deklarim të papajtueshmërisë në ushtrimin e detyrës së tij, sikundër shprehet edhe subjekti i rivlerësimit në ankim, nuk është një konkluzion i cili ka përbërë shkak për shkarkimin e tij, pasi konkluzioni përfundimtar i Komisionit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit bën fjalë për arritjen e nivelit minimal kualifikues. Për rrjedhojë, edhe shkak i ngritur në ankim nuk bën pjesë në gamën e shkaqeve të cilat sjellin një pasojë konkrete në drejtim të cenueshmërisë apo jo të vendimit të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjektit Edmond Hyka.
66. Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi të nevojshme marrjen në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit dhe kontrollin e arsytimit të Komisionit referuar fakteve të provuara gjatë hetimit dhe zbatimit të parashikimeve ligjore lidhur me to. Në këtë kontekst, trupi gjykues konstatoi se marrëdhënia e interesit së cilës i referohet Komisioni në vendim, mes subjektit të rivlerësimit dhe z. I. Ç., që ka lindur si pasojë e marrëdhënies juridike të shitblerjes së apartamentit të banimit me sip. 121 m<sup>2</sup>, në Durrës, ka përfunduar me regjistrimin e kalimit të pronësisë nga shitësi (z. I. Ç.) te blerësi (subjekti i rivlerësimit) në vitin 2005. Për rrjedhojë, kjo marrëdhënie që ka ekzistuar mes subjektit të rivlerësimit dhe z. C., nuk është objekt i parashikimeve të neneve 15 dhe 16 të Kodit të Procedurës Penale, ashtu sikundër kjo marrëdhënie nuk përkufizohet si një situatë e cila mund të përbëjë rast për heqjen dorë sipas nenit 17 të Kodit të Procedurës Penale. Në vlerësimin e trupit gjykues, marrëdhënia e shitblerjes e cila është përfunduar në vitin 2005, dhe nga e cila nuk rezultoi të ketë lindur ndonjë mosmarrëveshje mes palëve, e cila do të ishte prezente në kohën e përfshirjes së subjektit të rivlerësimit në çështjen penale objekt gjykimi (në vitin 2018), nuk përmbush kriteret për t'u vlerësuar si "interes në procedim" apo si "shkak i rëndësishëm njëanshmërie", raste këto për të cilat subjekti i rivlerësimit do të duhej të deklaronte heqjen dorë sipas kësaj dispozite ligjore. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se ndryshe nga sa ka arsyetuar Komisioni, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur detyrim ligjor për të hequr dorë në kuadër të parashikimeve të nenit 26 të Kodit të Procedurës Penale.

67. Në këto kushte, trupi gjykues, bazuar në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 33, pika 5, geramat “a” dhe “b” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, vlerëson se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, është i bazuar në fakte dhe në ligj dhe, për rrjedhojë, duhet të lihet në fuqi.

**PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

**VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 223, datë 20.12.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Edmond Hyka.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 07.04.2022, në Tiranë.

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

**RELATOR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*